



Viti i trembëdhjetë i botimit, mujore, Nr.2 (145) Shkurt 2011  
 gazetamokra@yahoo.com Kryeredaktor: FLORI SLATINA  
 www.poradeci.com/mokra

ÇMIMI 20 LEKE

# 8 Maji, tre kryetarë presin konfirmimin

Për zgjedhjet lokale të 8 Majit tre kryetarë kmounash aktualë presin konfirmimin nga Partia. Më të sigurt e ka kryetari i Trebinjës Feim Jashallari i LSI-së, që u zgjogj më 24 tetor. Dy të tjerët, Shaban Sula i PD-së në Proptisht dhe Ilia Mani nga LSI, në Velçan janë në pikëpyetje, pasi Partia nuk është aq e bindur për ta dhe klanet, me sa duket janë më të forta se ata dhe se "dëshira" e popullit.



Shaban Sula



Ilir Mani



Feim Jashallari

## Kuajt e natës



Tregim nga Istref HAXHILLARI

## Miku nga Frashëri

-Tregim për ndjenjat e shpirtit dhe besës gorare-

## Këngë epike për një shqiptar të vërtetë

Bisedë me miqtë për tabllonë "Oborr poradecar" e piktorit Gjergji Lako



## Model i përkushtimit në punë, korrektësisë dhe virtyteve njerëzore

-Një Homazh për Hysniun, që la pas një jetë model, në 20-vjetorin e ndarjes nga jeta-

Shqiptaro-amerikanët ndjekin gazetën "Mokra" në internet



Maliq Menkshi: "Më vjen turp nga deputetët, shahen me nënë e motër"



Mokra në histori:

## 7 Marsi i vitit 1944, rrethimi dhe lufta e Dunicës!

Bashkëbisedim me 90-vjeçarin Neim Agolli, si dhe me Myftar Spahiun

**Z**oti Neim, është kënaqë si për mua, besoj se do jetë edhe për lexuesit e gazetës "Mokra", të cilët do kenë rastin dhe mundësinë të mësojnë të vërtetën e vetëm të vërtetën, mbi atë ngjarje të largët të vitit 1944, "Lufta e Dunicës". Ju gjithë jetën tuaj jeni marrë me blektori e bujqësi por, sot unë dëshiroj të bisedoj me ju jo si bujk e blektor, por për një çështje me shumë rëndësi. Si e kujtoni dhe mbani mend ju atë ngjarje, duke nisur nga lufta italo - greke në Mokër?

- Po lufta italo - greke u zhvillua në fillim të viteve 40-të, në 1942-1943, në Mokër. Ky dyluftim kishte për objektiv e qëllim kapjen e majës së malit të Kozicës. Ushtria greke kishte kapur aso kohe Sanakosën. Pozhernën e Berberot ndanin sinoret e tokave të Dunicës, toka këto që janë në kufi më Niçën. Italianët kishin në hartë të piketuar si objektiv e deshin të kapnin kodrën në Berbero. Në Mokër grekët ndenjën të dislokuar 4-5 muaj dhe u tërhoqën në muajin prill të vitit 1943. Gjatë atyre muajve luftime nga palët ndërluftuese të luftës italo - greke u vranë shumë italianë. Ushtarët e vrarë në beteja, Italia i transportonte e varroste gjetiu. Edhe ushtarët e vrarë grekë tërhiqeshin e transportoheshin. Greku i mblodhi e i varrosi atje ku e sot i thonë Varret e Grekut. Për grekët Kozici ishte i rëndësishë së veçantë!

- Për ju Xhake, çfarë mund të thoni për Luftën e Dunicës?

- Rrethimi e Lufta e Dunicës është bërë në 7 Mars të vitit 1944. Kjo datë përkujtohej çdo viti me nderim, deri para viteve 1990.

Fshati i Dunicës atëhere kishte 130 shtëpi. Nga ato shtëpi, aso

kohe në fshat kishte më pak shtëpi të lidhura me Ballin, se të shumtat më pas u lidhën me luftën Na.Çl.

Mbas krijimit të Batalionit partizan të Mokrës nga Reshit Collaku, vazhdimisht kishte kërkesa për t'u regjistruar e dalë në mal partizan për të luftuar okupatorin nazifashist, deri në çlirimin e plotë të vendit. Komandat e batalionit të vendit iu përgjegjën thirrjes, dolën shumë partizanë edhe nga fshati jonë. Kujtoj të parët kanë qënë Bilal Xhaja, Ismail Spahi, Sejat Sofi, Dilaver Agolli, me vullnet e dëshirën e tyre. Në prill të vitit 1944 u mobilizuan dhe u morën shumë djem 50 - 60 partizanë në këta partizanë nga fshati jonë, ndër ta bënin pjesë Gani Xhaja, Sheme Spahi, Arif Spahi, Iliaz Lazellari etj

- Xha Neim, çfarë dini e ç'mund të na thoni për rrethimin e forcave të Ballit Kombëtar në fshatin tuaj Dunicë, të cilat komandoeshin nga Haki Blloshmi?

- Në datën 6 mars 1944 erdhën në Dunicë, forca të shumta të Ballit, bëhej fjalë për 400 ballistë, të cilat kryesoheshin nga Haki Blloshmi, Sadiku Turtulli, Bami i Trebinjës. Ardha e ballistave kishte për qëllim të rekrutimin e regjistrimit gjithë burrat e afta për luftë me Ballin dhe të mos inkuadroheshin me Batalionin partizan të Mokrës, "Reshit Collaku", pasi mes këtyre dy kampeve kishte ndryshime ideologjike, siç u muar vesh më pas.

Shtëpia jonë ka qënë një nga familjet më të mira të fshatit, një nga shtëpitë që kanë qënë vërtet atdhetarë, nacionalistë të vërtetë për vatanë e tyre, që i ka dhënë luftës dhe ka shërbyer si bazë e luftës për çlirimin e vendit.

(vijon ne faqen 5)

# HIDROCENTRALI NË SLABINJË PO NDËRTOHET SIPAS FAZAVE

**H**idrocentrali i Slabinjës vazhdon normalisht të ndërtohet, vazhdon betonimi i kanalit të ujit, duke aritur tek Rrushi i Kullës në Slabinjë. Kanë ardhur tubat metalike të hidrocentralit, janë me dimensione të ndryshme. Po ndërtohet godina e hidrocentralit tek sheshi i urës Tereziut. Ujrat e tepërta të rezervuarit do të dalin e do të shkarkohen në kanal që shkon tek përroi Mushatës.

Po punohet për marrjen e

ujrave të lumit të Trebinjës, për këtë të hapet rruga për të ulur poshtë lumin Shkumbin tek Gradishta e Slabinjës, poshte. Pas kësaj do të bëhet rruga nga lumi Shkumbin lart.

Lumi i Trebinjës do të futet në kanal dhe do të dalin në kanal e hidrocentralit tek sheshi i Madh në fshatin Slabinjë, me sistem tubash. Kjo e shton sasinë e ujrave në kanal e hidrocentralit, sidomos në verë.

Në kanal e hidrocentralit, do të futen të gjitha ujrat e lumit Sh-

kumbin, me përjashtim të ujit të zi.

Linja elektrike është e ndërtuar, me shtylla të sistemit të lartë dhe do të lidhet me sitemin e lartë energjistik të vendit.

Hydrocentrali Nr. 2, i Bishnicës është futur në funksionim dhe është lidhur me sistemin e lartë energjistik që në vijën nga Çervenaka. Punet në këtë hidrocentral, po vazhdojnë normalisht sipas fazave të ndërtimit dhe sipas projektit.

**Xhemal FERRO**  
Slabinjë 10 Janar 2011

## Shqiptaro-amerikanët ndjekin gazetën "Mokra" në internet

Nga Zenun FERRO

**N**ga viti 1992-2011, nga fshati Slabinjë, u kanë dalë llotot për në SHBA, për të punuar e banuar atje.

Është një e veçantë, se llotaria amerikane ka zgjedhur ata nga Pogradeci, e sidomos nga Mokra. Emrat që na njohin janë të shumtë, nga çdo fshat, kemi ndjerë emociione të mëdha kur jemi ndarë me ta, dhe kanë shkuar.

E veçanta ka qënë e rëndë, i kemi përcjellë, jemi ndarë me mallëngjim, emocione. Ata shkuan me familjet e tyre, me fëmijët, natyrisht, në vendlindje kanë lënë kujtimet, prindërit shoqërinë e tjerë. Ata hera, herës vijnë prapë, na takojnë dhe çmallen me çdo gjë.

Fshati Slabinjë, ka dërguar në SHBA mbi 15 familje e më shumë. Në SHBA kanë shkuar Astrit Balliu, (1997), Bujar Gorica, (1998), Safet Bego, (1998), Niko Fero, Tafil Sinani, Lavdim Sinani, Riza Hamit Balliu, Ramadan Balliu, Dëfrim Balliu, Erald Fero (2010) e tjere e tjerë. Nga Pogradeci, Mokra janë me qindra familje, kjo llotari e ka vlerësuar këtë zone.

Ata vijnë për pushimet e verës

çdo vit, por vijnë edhe kur kanë probleme familjare. Ata ndihmojnë prindrit që kanë lënë në vendlindje, vëllezërit dhe motrat që kanë probleme ekonomike.

Edhe Dëfrim Balliu, e Mimoza Balliu erdhën më 30 janar 2011 për të parë nënën e tyre Sabrie, që ishte e sëmurë. Erdhën nga larg për të parë nënën e tyre, për t'u çmallur me të. Qëndruan një javë, pasi ajo u përmisua e u larguan, por mendjen e kishin aty.

Për prindërit u kujdesën, u siguruan kushte më të mira në Pogradec. Shtitën shtëpinë në fshatin Slabinjë, dhe i siguruan prindërit me kushte të plota e shumë më të mira në qytetin e Pogradecit. Kjo është një anë shumë e mirë, shqiptarët kujdesen për familjet e tyre, kanë dashuri e respekt. Familja shqiptare po ndryshon jetë e fat, të mos dobësohet, por natyrisht hapja me botën ka sjellë edhe tek ajo të çara.

E vërteta është se kanë mall për Shqipërinë, marrin shpesh në telefon, e internet. Kolegu im Durim Lilo shkoj më 7 mars 2010, me familjen në SHBA, neve mezi u ndamë nga njëri tjetri, nga malli dhe dashuria për njeri tjetrin. Kemi kaluar mbi 12 vjet bashkë në punë.

Pra ndarja u bë me sy të përloitur dhe me mall e dashuri, nuk është e lehtë të largohesh nga vendlindja. Natyrisht koha bën të sajën, jeta kërkon, kushte ekonomike. Ai mban lidhje të plotë me gjithë njerzit.

Nuk ndahen njerëzit në Shqipëri, na bëjnë urime për dasma apo hidhërime e tjera. Është Donika Shahini, (Fero), që është në SHBA, na merr në telefon herë pas here, vjen në Pogradec çdo vit.

Për ngjarjet ato lidhen me të gjitha mënyrat. Më kanë habitur se e kishin lexuar gazetën "Mokra" në internet. E dinin se gazeta "Mokra" ka kryeredaktor Flori Slatina. Më thoshin për numrat e gazetave, për lajmet e zonës, për artikujt, për ngjarjet e tjera. U habita jo për këto, por se këta kanë nevojë për të njohur dhe patur sa më shumë informacione nga zona dhe sidomos nga e Mokrës. Duan të dinë se çfarë ndodh, në vendlindjet e tyre.

Falënnderit shumë të gjithëve, që ndjekin gazetën "Mokra"

Me këtë rast, i uroi suksese, shëndet kudo që jeni.

Vendlindja ju uron kudo që të jeni.

Ju kokën e keni këtu dhe mirëse të vini here pas here.

andej, në ata pyjet e bukur të Bishnicës (nese nuk gaboj), parajsë... Njësoj si malet e Rrajcës dikur, Likopathrrës, kështu e thërras unë..

Gjithashtu do miqësohem me ju me shume sepse aty në faqet tuaja gjeta mikun tim, të veçantin, ai që mban me vete kaloritë e gjithë botës, të ëmblin, Kopi Kycyku, i cili sikur ta ndiente rrahjet e zemerës time, më kishte cituar edhe mua, po si mund të zë vend unë pranë tij?

Unë rrah temën e NAFTAES. Sidoqoftë do te kemi pika takimi. Ata qe duhen kane pika takimi! Jam ne dispozicionin tuaj.

**Suksese, shëndet dhe mirësi.**

**Shumë miqësisht, Ahmet ÇOLLAKU**

## LETRA/"Mokra dhe Rrajca janë dy "mbretëri" që nuk kanë opozitë"

Të nderuar zotërinj të Mokrës dhe të gazetës "Mokra"!

Tani afër u takova në internet me gazetën tuaj MOKRA. U emocionova shume sepse, autostrada që kalon nëpër Domosdovë, ngjitur me arën time, Ara e Danes, mu bë si një plan simetrike, ku Rrajca

ime shikon Mokrën tuaj. Mokra dhe Rrajca janë dy mbretëri qe nuk kanë opozitë, i ka lidhur Zoti. Simetri lulet, simetri rakia, simetri zemrat e njerëzve, gurët, simetri dashuritë, inatet me të tjerët, simetri me pyjet...

Vetëm një herë kam kaluar

Kryeredaktor; Flori SLATINA

Redaksia: Haki BALLIU, Zenun FERRO, Istref HAXHILLARI, Zabit ÇUKU, Sami LEKA, Pëllumb ZADE, Llazi TONA

Pëllumb ZADE, kryetar i shoqatës "Pelioni"  
Istref Haxhillari, Zabit Çuku, nënkryetarë të shoqatës  
Zenun FERRO, sekretar i shoqatës

Që nga numri 111 gazeta "Mokra" ka dalë në internet, ne adresën e mëposhtme:

[www.pogradeci.com/mokra](http://www.pogradeci.com/mokra)



## MËSUESI ARIS FERRO KTHEHET NË VENDLINDJE, MËSUES NË SHKOLLËN 9-VJEÇARE TË SLABINJËS

**M**ësuesi Aris FERRO është djalë prej Slabinje, lindur në këtë fshat ne vitin 1954, ka mbaruar shkollën 8-vjeçare në vitin 1969 dhe dërgohet për të vazhduar shkollën e mesme të Përgjithshme, në qytetin e Pogradecit, të cilin e mbaroi në vitin 1973.

Për rezultate të mira, i doli e drejta e studimit të vazhdojë institutin e gjuhë-letërsisë në Elbasan, të cilin e mbaroi në vitin 1973-1976. Punoi për pak kohë në shkollën e Proptishtit e më pas, për nevojat e arsimit caktohet mësues gjuhë-letërsie në fshatin Slatinë, ku punoi disa vite, ku u shqua si mësues dhe drejtor i kësaj shkolle, detyrë që e mbajti deri në vitin 1985.

Për punë të mirë sillet mësues gjuhë-letërsie në shkollën e mesme Bujqësore, në Propishtit, ku kaloi shumë breza që nga viti 1985- e deri në gusht të vitit 2010. Brezat e nxënëseve që ka nxjerrë thonë fjalët më të mira, e njohin të gjithë në Mokër Pogradec. Ishte shumë i dashur, mikpritës për çdo shok e mik. Ai

në këtë shkollë punoi për 25 vjet, në lëndën e gjuhë-letërsisë. Për nxënësit ishte nga më të njohurit. Ai ishte i apasionuar pas kësaj lënde dhe e ka dhënë nga viti 1976-2010, mbi 36 vjet, një pasion i madh për këtë lëndë.

Por kjo nuk vazhdoi më, strukturat e emëruan, në gusht 2010, për të dhënë mësim në fshatin Slabinjë, në fshatin e lindjes. Natyrisht ky nuk është një respekt për punën e tij, ai krijoi para disa vitesh banimin në Pogradec, natyrisht për kushte më të mira.

Natyrisht, atij i ka ardhur keq se ishte larg, mosha, shëndeti e tje por nuk u tërhoq nga profesioni i mësuesit. Ai shkon çdo ditë në rrugën e mësuesi Pogradec-Slabinjë, e kthim, mbi 100 kilometra në ditë. Por ky trajtim, kjo largësi, nuk duhet të ishte për atë, për një mësues me mbi 36 vjet punë. Ata nuk i ndan nga përfaqsimi i mësuesit, ata atje e kanë mendjen, për të thënë çfarë të duhen. Mësuesi vdes si mësues, nuk e ndryshon profesionin. Le të respektojmë këtë profesion, t'i trajtojmë më mirë mësuesit për vlerat dhe eksperiencat që kanë fituar.

## MËSUESIT JONUS ROKO I NDËRPREZIN PROFESIONIN E MËSUESIT

Mësuesi Jonus Roko, ka lindur në fshatin Slabinjë në vitin 1949, vazhdoi shkollën fillore në Slabinjë, dhe shkollën 7- vjeçare në Propishtit.

Pas kësaj dërgohet në vitin 1964 të ndjekë shkollën e Mesme Pedagogjike në Korçë, që e mbaroi në vitin 1968, me rezultate shumë të mira. Me mbarimin e shkollës Pedagogjike për mësues, dërgohet për të dhënë mësim në zonën e Mokrës, në shkollën e ciklit të ulët. Më shumë ka dhënë mesim në fshatin Losnik, bashkë me mësuesin Selman Leka dhe pas kësaj dërgohet në fshatin e lindjes Slabinjë.

Mësues Jonuzin nxënësit e kanë vlersuar për përkushtimin e tij si mësues, kërkues dhe i rregullt, të bëjë që të mësojë. Natyra e tij serioze e rregullt, kërkues, vlersohet një nga mësuesit më të mirë në Mokër. Prindrit dhe familjarët e donin që fëmija i tyre fillonte klasën e parë, me mësues Jonus Rokon, sepse e dinin që fëmija i tyre do kishte disipilinë, dhe do të mësonte.

Në fshatin Slabinjë, mësuesit e ciklit të ulet ishin me emër të mirë,

si Jonus Roko, Kajane Balliu, Çelik Fero e tjerë. Por tani edhe mësuese Kajane Balliu me bashkëshortin Riza Balliu, u del llotaria për në SHBA, në vitin 2006, mësuesi Çelik Fero në vitin 2009, nxiret jashtë sistemit arsimor, për mos kualifikimin të mëtejshëm, sipas kritereve të vendosura.

Mesuesi Jonus Roko, nxiret jashtë sistemit arsimor, në gusht 2010, për mos kualifikimin e tij të mëtejshëm në moshën 61 vjeçare, ku do edhe katër vjet të tjera, për të dalë në pension. Ai i dha arsimit shumë të mira në zonën e Mokrës, atë e njohin të gjithë nxënësit e fshatarave, dhe ata të Slabinjës që nga vitet 1980-2010. Natyrisht largimin e priti me hidhërim, një punë në arsim e filloi dhe punoi për 42 vitesh kaluara, vlersimi i strukturave arsimore në Pogradec, duhet të ishte më i lartë, për këtë brez mësimi, dhe ata i kishin mbaruar kusuret kualifikimi, por nuk i lane në punë mësimore, dashuria për mësimin. Ne stafi gazetës Mokra, urojmë mësuesin Jonus Roko shëndet, dhe mos u ndaj nga puna e mësuesit ju mund të jepni edhe jashtë mësimin.

Zenun FERRO

# “Më vjen turp nga deputetët, shahen me nënë e motër”

Maliq Menkshi: “Më vjen turp kur shoh ato skena dhe ato karrige ku unë kam qenë i ulur si deputet për 12 vjet. Ju rroftë shkolla deputetëve të sotëm se nuk kanë pikë etike e shajnë njëri-tjetrin nga nëna dhe motra”.

Bardhyl BERBERI

- Zoti Menkshi, cila është rru-  
ga juaj deri kur u bëtë deputet?

- Kam lindur në një fshat të thellë të Mokrës dhe që në moshën 12 vjeç kam filluar të punojë. Fill pas klasës së shtatë fillova të punojë si minator në Pishkash dhe më pas në minierën e Gurit të Kuq. Gjithmonë kam qenë në pararojë, ndonëse shumë i ri në moshë në vitin 1970 propozohem për deputet në zonën nr. 166 të Mokrës dhe zgjidhem deputet për tre legjislatura rresht nga viti 1970 deri në vitin 1982.

- A mund të na thoni se çfarë privilegjeshte kishte atëherë një deputet?

Privilegji i vetëm ishte se kur shkonim në Tiranë për séancë parlamentare udhëtonim pa lekë me tren apo autobus dhe merrnim 40 lekë dietë në ditë, ku futej edhe fjetja edhe ushqimi që konsumonim gjatë ditëve që qëndronim në parlament. Rroga nuk kishim siç kanë këta deputetët e sotëm. Kur mbaronte séanca parlamentare i hipja trenit dhe vija në Pogradec, hiqja kostumin e deputetit dhe vishja kostumin e minatorit dhe shkoja atje në ballë të galerisë dhe nxirra mineral hekuri.

- Cilat janë raportet, kur ju ishit deputet në kohën e monizmit me deputetët e sotëm?

- Të them të drejtën më vjen turp kur shikoj ato skena dhe atë karrige ku unë kam qenë i ulur për 12 vjet. Ju rroftë shkolla deputetëve të sotëm se nuk kanë pikë etike e shajnë njëri-tjetrin nga nëna dhe motra, vishu e zhvishu lakuriq. Është ndërruar salla e parlamentit, por jo mendjet e deputetëve, janë po ato sharje dhe po ajo gjuhë e ashpër. Po ju kujtoj një moment që në shtypin e kohës është shkruar shumë për një moment kur unë kam kundërshtuar Enver Hoxhën për problemet e tufëzimit në Kuvendin e Shqipërisë. Na ishte dhënë direkti-



Maliq Menkshi

va që duhej të bënim tufëzimin e bagëtive në të gjithë vendin. Unë si deputet i Mokrës dhe përfaqësues i tyre në Kuvendin Popullor nuk e zbatova këtë direktivë që ishte shumë e rëndë për Mokrën, e cila mbante frymën gjallë vetëm me blegtori. Kaluan muaj dhe informacioni i shkon dhe Enver Hoxhës. Në takimin e radhës në parlament, Enver Hoxha thotë: Le të ngrihet ai deputeti i Mokrës dhe të na thotë se pse nuk zbaton direktivën e Partisë. U ngrita unë në parlament dhe i argumentova Enverit se është e gabuar kjo direktive, pasi Mokra është kra-hina më e thellë dhe fshatarët janë të varfër dhe më atë pikë qumësht dhe bulmet mbajnë frymën gjallë. Pasi qëndroi një moment Enveri tha - Mokrën mos e trazoni, deputeti i saj ka të drejtë.

- Zoti Maliq si guxuat të thoshit një gjë të tillë?

- Është e vërtetë, ishte marrëzi e jo guxim që të kundërshtoj Enver Hoxhën, por unë nuk kisha asnjë privilegj. Çfarë do të humbisja, isha vetëm minator në ballë të galerisë, ndërsa këta deputetët e sotëm i pari i maxhorancës apo opozitës i komandon si ato kukullat e kartonit. Po doli njëri nga rreshti i fluturon rroga, makina luksoze, bizneset që komandojnë. Unë isha minator që qëndroja në një shtëpi, një dhomë e kuzhinë në katin e pestë.

Tani para pak kohësh, me djersën e djemve emigrantë në

Greqi, kemi bërë një shtëpi tjetër, kurse deputetëve të sotëm nuk iu numërohen vilat dhe hyrjet nëpër qytete të tjera apo në bregdet. A e di ti sesa deputetë e pushtetarë kanë bërë vila dhe kanë blerë hyrje në Pogradec, vetëm për të pushuar një muaj në verë? Vetëm një ndërtues që unë e kam mik më tha se u ka shitur mbi 50 hyrje luksoze, ku 20 prej tyre i kanë deputetët e sotëm dhe të tjerat pushtetarë. Madje ai më tha dhe emrat, por nuk ia vlen t'i kujtojmë me emra se janë shumë. Ku i gjejnë paratë ata? Është gjynah të abuzosh me këtë popull fukara. Deputetëve dhe politikanëve të sotëm do t'ju bjerë në kokë, atje ku nuk e presin, kur vjedhin djersën e popullit.

- Cili është mesazhi juaj për deputetët e sotëm?

Në vend të mesazhit po të tregoj një rrëfenjë interesante që ka ndodhur para shumë vitesh në Mokër. Ishte një çoban dhe merr një nuse nga një fshat fqinjë me mblesëri, siç ndodhte atëherë. Nusja që në fillim e kishte zakon që i kundërshtonte për gjithçka burrit të saj. Kur ishte dimër, ajo linte dritaret e dhomës hapur, ndërsa ai u mbyllte dhe ajo i hapte prapë. Ai i kërkonte gjellën e nxehtë dhe ajo ia sillte të ftohtë. Mos e zgjat gjithçka kundra asaj që i thoshte i shoqi. Një ditë bariu vjen nga mali dhe gunën e lagur e vendos mbi pus (kapakun e kishite të hapur) për t'u tharë. I thotë së shoqes që të mos ulej mbi gunën se e kishte lënë që t'i thahet. Por, gruaja që bënte gjithmonë të kundërtën e asaj që i thoshte i shoqi, shkon dhe ulet mbi gunë tek gryka e pusit. Gruaja bie në fund të pusit me gjithë gunën dhe mbytet. Mesazhin e këtij rrëfimi le ta zbërthejë vetë lexuesi, pasi iu shkon këtyre politikanëve tanë që shkojnë kundra njëri-tjetrit duke rrahur ujë në hava dhe duke bërë diskutime pabukë që nuk i shërbejnë popullit.

## MJEKU THEODOR JORGONI, NJË JETË E TËRË PA GJUMË NË SHËRBIM TË NJERËZVE, POGRADEC

Nga Zabit CUKU

Theodor Jorgoni lindi në vitin 1908, në Tiranë në familje tregëtare. Ishte diplomuar në universitetin e Romës në degën e pediatri-së kirurgjikale. Në vitin 1942, Theodor Jorgoni kthehet në Shqipëri, për të luftuar kundër pushtuesëve fashistë. Fillimisht punon në spitalin ushtarak, dhe në spitalin Pediatrik në Tiranë. Në këtë spital punoi me mjekë rusë, dhe fitoi një eksperiencë të madhe pune. Punoi me mjeken e shquar, ruse Kazanove, që ishte mjekë e Leninit. Ajo ishte një mjekë e moshuar dhe kishte ardhur në Shqipëri për të ndihmuar mjekët shqipëtarë. Me mjeken Kazanova, kemi kuruar një djalë 6 vjeçar nga fshati Dunicë i Mokrës, që quhej Çelik. Djali u mjekua për tre muaj por përmisime nuk kishte, mjekimi vazhdoi më tej. Kazanova nuk u dorëzua dhe djali pati përmisime. Më 9 gusht 1958, mjeku Theodori Jorgoni emërohet mjek në qytetin e Pogradecit, dhe aty punoi gjatë gjithë kohës. Në Pogradec, në atë kohë punonte vetëm mjeku Misto Marko. Ai punonte shumë gjithë ditën në spital, punonte mbi 16 orë në ditë. Për Mokrën ai ka shumë kujtime ishte viti 1963, dëborë e madhe, dhe nga Pogradeci u nisën duke udhëtuar 6 orë, në këmbë, përmes dëborës, dhe shpëtoi një foshnjë 6 javëshe. Edhe pas daljes në pension, edhe tani në moshën 92



Theodor Jorgoni

vjeçare ai punon po me aq pasion. Për mjekun Theodor, pasuria më e madhe është respekti i njerëzve të thjeshtë, të cilët sa herë që kalojnë rrugës na flasin, e na flasin me dashuri. Mjeku Theodor, tani jeton bashkë me bashkëshorten Vitoria sepse djemtë i ka në emigracion, Urimin dhe Gencin në Kanda. Ky Tiranasi një djalë i një tregëtari, nuk u kthye në Tiranë edhe pse atje ka punuar prona. Ai braktisi Tiranën për Pogradecin. Për kontributin e jashtëzakonshëm më 30 korrik 1984, mjeku Theodor Jorgoni, u dekorua nga Presidumi i Kuvendit Popullor me titullin ‘Mjeshtër i Punës’. Dhe tani mjeku Jorgoni, kuron njerëz në ndonjë sëmundje të rrallë. Ai i pret me dashuri, me respekt dhe duke qeshur duke ju dhënë ndihmën dhe mjekimin njerëzor.



## RRITET ÇMIMI I BARNAVE

Nga Prof. Isa GORICA

Kryetar i Sindikatës të Pensionistëve

Rritja e barnave tashmë do të rëndojë mbi xhepat e qytetarëve. Por më të revaloruarit nga vendimi për rritjen me 10 % të TVSH-së së barnave duket se janë pensionistët. Rritja e çmimit të barnave është e papërbalueshme nga ata. Kjo rritje e çmimit ndikon mbi xhepat e pacientëve, por është edhe në kurriz të distributorëve, pasi do të jenë këta të fundit, të cilët do të paguajnë 10 % në doganë. Rritja e barnave me 10 % në doganë është e papërbalueshme për pensionistët.

Vetëm 50 % e barnave janë të rimbursueshme, çka do të thotë se pjesa tjetër do të blihet nga të moshuarit e si pasojë 10, përqindshi rëndon direkt mbi xhepat e tyre. Në shumë raste pensionistët nuk marrin barnat me rimbursime, pasi alternativat e para që kanë futur në listë nuk janë eficientë dhe në këto kushte ata i blejnë vetë. Pensionet, janë më pak se 100 mijë lekë të vjetëra dhe rritja e barnave është një barrë e madhe që bie mbi ta rreth

500 mijë pensionistë, të cilët nuk kane mundësi të përballojnë as nevojat më elementare të jetës. askush nuk e merr në konsideratë këtë problem madhor që u del përpara pensionistëve, por shteti kërkon të perfitojë në kurriz të pensionistëve. Duke shpeguar sipas llogaritjeve, rreth 20 milion euro në vit fiton shteti, pikërisht në kurriz të pensionistëve me këtë 10 për-qindëshin e TVSH-së. “Kjo është e tepër dhe e papranushme për ne”. Futja për herë të parë e TVSH-së për barnat ndikon direkt në rritjen e çmimit të tyre. Kështu një pako aspirinash që, sipas farmacistëve tërhiqet shumë nga pacientët, pasi veç dhimbjes përdoret për hollimin e gjakut dhe një sërë sëmundjesh të tjera, pa TVSH kushton 250 lekë, të vjetra ndërsa sot me futjen e TVSH-së ajo kushton 280 lekë, pra me 30 lekë më shumë që për një pensionist do të thotë një gjysmë buke. Në disa farmaci në kryeqytet, ende nuk kanë filluar të tregëtojnë medikamente me TVSH për ato sasi, të cilat i kanë patur gjendje, me qëllim për të ruajtur klientelën, pasi sipas tyre, shitja me çmim ndryshe nga ai i vënë në pullë u krijon probleme pacientëve. Ndërkohë, pas problemeve të shkatuara deri tani, Ministria e Financave ka nxjerrë një udhëzim ku sqaron, se medikamentet që janë gjendje do të tregëtohen me çmimet që mbajnë në pullë, ndërsa furnizimi i ri do të shitet me 10 % TVSH

## EKSPOZITA “DITË DIMRI,, ME STANDARDE PERENDIMORE NË POGRADEC

Në Pogradec nga data 21-23 Janar 2011 u zhvillua ekspozita “Ditë Dimri,, edicioni i dytë. Ky ishte një prurje e dukshme për t'u kthyer në një aktivitet elitar artistik.

Në këtë ekspozitë morën pjesë piktorë nga gjithë trevat shqiptare dhe piktorë të mirënjohur vendas. Ishin 45 autorë dhe punime të fushës së pikturës dhe skulpturës që erdhën në ekspozitë. Kjo ekspozitë u hap për herë të dytë, ishte e planifikuar në planin mbarëkombëtar. Erdhën artistë nga të gjitha trevat Shqipëtare, duke dëshmuar së pari për unitetin më të madh që kanë njerëzit e kulturës dhe të artit.

Ky aktivitet u konceptua si ide edhe formë, dhe u mbështet materialisht nga artistët dhe fotografi Ardian Fezollari dhe u përkrah nga artistët vendas. Veprimtaria e këtij viti u kurua nga Vangjel Vasili, Gentian Zeka dhe Neli Naço. Ekspozita “Ditë Dimri,, erdhi bashkë me katalogun dhe mund të quhet me të drejtë një aktivitet i standartëve perendimorë.

Ardian Fezollari, Neli Naço



PORTRET

# Model i përkushtimit në punë, korrektësisë dhe virtyteve njerëzore

-Një Homazh për Hysniun, që la pas një jetë model, në 20-vjetorin e ndarjes nga jeta-

Nga Dhimitër Gegprifti

### Njerëz të vlerësuar të një krahine

Mokra është një trevë e njohur historikisht, por dhe etnikisht, për traditat e saj shoqërore dhe kulturore. Ajo është dalluar dhe dallohet për njerëzit e saj të mirë e të ndershëm, punëtorë e të palodhur, të mikpritjes, të këngës e të humorit. Natyra me resurset e saj u ka dhënë këtyre njerëzve bujarinë, ndershmerinë, sinqeritetin, duke u kthyer në modele të jetës shoqërore.

Këta mokrarë dhe këta modele i gjen në jetën e përditshme të kësaj treve në të 31 qendrat e saj urbane. Në këto qendra jeta vazhdon rrjedhën e saj me të mirat dhe vësh-tirësitë e saj.

Kalivaçi një nga qendrat e Mokrës së Sipërme, ku personazhi kryesor i shkrimit tonë është Hysni Baki Fezollari, trashëgimia e tij e vyer, që ka lënë pas, si model për fëmijët, familjen, të afërmit, por edhe për të gjithë ne. Por cili është Hysni Baki Fezollari?

### Pasaport


Hysniu u lind në fshatin Kalivaç të Mokrës Sipër më 1 shkurt 1929 dhe u nda nga jeta më 24 shkurt 1991. Është i biri i Bakiut dhe i Xhevahires. Ai ishte një autodidakt për çdo gjë, por në radhë të parë për të mësuar shkrim e këndim. Shquhej për një shkrim të bukur e të rrjedhshëm, të cilin e kanë trashëguar, të gjithë fëmijët e tij. Pas kryerjes së shërbimit ushtarak të detyrueshëm në reparte këmbësorie në Tiranë, kryen një kurs ekonomik në qytetin e Korçës.

Kryen fillimisht detyrën e ekonomistit dhe më vonë atë të shefit të llogarisë në ish-kooperativën bujqësore të Podkozhanit.

Me krijimin e ish-Kooperativës së Bashkuar me qëndër në Trebinjë, kryen detyrën e brigadierit e mandej të përgjegjës të sektorit deri në momentin e daljes në pension. Jeta dhe figura e tij morale shërbeu dhe vazhdon të shërbejë si model përsosmërie për të pestë fëmijët e tij: Fahriu, Selamiu, Selvikua, Zeni dhe Mimoza, por edhe në memorijen e të afërmeve, miqëve, shokëve, vëllait Kudreti, të nipërve, mbesave, që nuk janë të paktë dhe e kujtojnë atë me admirim...si prind, bashkëshort, si vëlla, si mik, si shok të vyer.

### Njeriu që la pas një jetë model

Njeriu vjen dhe ikën nga kjo botë si qenie e gjallë, që lind, rritet e formohet në kushte të caktuara të një shoqërie dhe vepron në të. Me vepërmat e tij ai lë gjurmë të pashlyeshme tek ata, që e rrethojnë dhe tek ata, që kanë marrdhënie dhe raporte të caktuara me të. Një ndër ta është dhe "personazhi" i nderuar i shkrimit tonë,



Hysni Fezollari.

Ai nuk jeton më fizikisht, e me gjithë atë, shfaqet në memorien vizive të kohës dhe të atyre, që e kanë njohur, kanë punuar, kanë qeshur, kanë biseduar, pse jo dhe kanë këmbyer urimet dhe gotat e rakisë me miqtë si mokrar të vërtetë. Nga testimi ynë në opinion për këtë figurë publike, pothuajse kemi marrë të njëjtat vlerësime. Do ta themi me bindje, nëse do të vazhdonim akoma, jo vetëm në fshatin e lindjes Kalivaç, por edhe Podkozhanin, si fshati më i afërt dhe më bashkëpunues për atë komunitet, do të vazhdonin të evidentonin vlerat pozitive të tij.

Por ne morëm mendimet, përshtypjet, opinionet e njerëzve të tij të afërt dhe kjo është e natyrshme, pasi ata kanë qenë më afër. Kështu u shprehën zotërinjtë Feim Jasharllari, nga i njëjti fshat, kryetar aktual i komunës Trebinjë, specialist i lartë në fushën e Bujqësisë, kuadër në ish-Kooperativën e Bashkuar, vëllai Kudreti dhe njëri nga djemtë e tij, Zeni, ushtarak në lirim.

Feim Jasharllari- Nëse kërkoje një gjerman për ta pasur si model të punës, të korrektësisë, të disiplinës e të drejtësisë, kishte Hysniun. Ai realisht në çdo kohë vendoste interesin e përgjithshëm mbi atë personalin. Shquhej për korrektësinë, por edhe për humorin e tij të hollë e të ëmbël në kto dy fshatra. Ishte një njeri kundër veseve të këqia në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë kundër duhanit dhe alkoolit. Burrat e Kalivaçit, sipas gojdhënës, me origjinë nga Labëria, sa kanë të përbashkta, kanë edhe të veçanta dhe shquhen në zonë: xha Bakiu simbol i humorit dhe i mëndjes së hollë, xha Demiri i mënçuri i fshatit, xha Sulka burrë tabani e kështu me radhë...

-Ka qenë person i veçantë në karakter, i filloi mbresat e tija, vëllai Kudreti, Nazifi duke u munduar të mbante lotët, për fjalën e dhënë dhe mbajtjen e saj, por ai mbahet mend dhe për humorin pa të keq, me të gjithë. Hysniu ishte një kursimtar, që dinte ta ruante dhe ta përdorte me nikoqirllëk paranë dhe ishte në çdo kohë i gatshëm për të ndihmuar kush të kishte nevojë.

Sëmundja deshte ta mposhte, por e kish të pamundur, pasi ishte me vullnet të jashtëzakonshëm, e përballoi deri në minutat e fundit.

Por jo vetëm kaq, ai ishte një mik i vërtetë. Këtë e vërtetojnë ata, që kanë qenë miq na këtë shtëpi. Dashuria e sinqertë për ne vëllezërit dhe motrën e vetme Rrushkën, niprit e mbesat ishte një cilësi tjetër i karakterit të tij. Ai nuk u bë asnjëherë anëtar i PPSH, pasi në të nuk shikonte njerëz serioz e model, siç shkruhej e duhej të ishin. Po çfarë kujton dhe ruan sot si "të shenjtë" nga babai, djali i tij Zeni?

-Më të mirat, që mund të thuhën dhe këtë e them me gjithë shpirt. Kërkuem, por edhe tolerant. Dashamirës i përkushtuar për arsimin, gjë, që vërtetohet me arsimimin e fëmijve: dy me arsim të lartë (Moza e Zeni) dhe tre me arsim të mesëm, megjithëse në kushte jo të mira ekonomike. Ai kishte një kërkesë të fortë ndaj vetes, por edhe ndaj nesh, i përkushtuar dhe ekzigjent për çdo gjë. I drejtë, i ndershëm, si rrallë të tjerë.

Ai në sytë tanë dhe në memorijen tonë sot mbetet model i një prindi dhe bashkëshorti model edhe për ne. Këto raporte dhe këto marrëdhënie i ruante edhe me të tjerë.

Të gjitha këto formojnë figurën morale dhe publike të një njeriu të thjeshtë, që ishte dhe mbeti model për veten, për familjen, për fëmijët, por edhe për të tjerët. Një nga ish-kryetarët e ekonomisë është shprehur: Po t'i kishim të gjithë kuadrot si Hysniu, që punon me ndershmëri e përkushtim, me gjithë mungesën e resurseve, do të konkurronim denjësisht dhe ekonominë e Buçimasit. Dhe për këtë fëmijët dhe të afërmit kanë të drejtë të krenohen dhe të ecin të sigurt në rrugën, që u tregonte Ai, Hysniu.

Le të shërbej ky shkrim një homazh përjetësie nga njerëzit e dashur të tij, por edhe nga ne, që kemi patur fatin ta njohim atë nga afër!



## Nga Mokra e Berati gjermanët fillonin operacionet luftarake

Nga Zenun FERO

Në shtator të vitit 1943, pas kapitullimit të Italisë, erdhi në Tiranë gjenerali gjerman Beseli, i cili mori kontakt me gjeneral Aqif Permetin, kolonel Sami Kokën dhe ish gjeneralin Gustov Van MYRDACH si përkthyes.

Ibrahim Biçaku në bashkëpunim me Von Schaiger, atashe tregëtar i konsullatës gjermane mori iniciativën dhe formoi komitetin ekzekutiv. Me ardhjen në Tiranë të përfaqësuesit politik të Hitlerit, ministër fuqiplotë Neubacher, i cili qëndronte në Beograd, filluan bisedimet për formimin e një komiteti ekzekutiv.

Neubacheri inisistoi që komiteti të formohej sa më shpejt, që çështja e Shqipërisë të përmendej në fjalimin e afërt që do të mbante Hitleri. Ai insistoi që të formohej një asamble e cila të shpallte independencën shqiptare dhe të shkëpuste Shqipërinë nga Italia.

Nga mbledhja e dytë e zhvilluar në sallën e bashkisë, Tiranë doli komiteti. Gjermanët kishin besim të plotë te Xhaferr Deva dhe te Ibrahim Biçaku, i cili kishte miqësi të vjetër me Van Scheiger, por më shumë besim kishin te Deva, i cili kishte marrë dekoracion nga Hitleri.

Në Shqipëri përfaqësuesi i Hitlerit ka qenë gjeneral Fitzthum i cili ka qenë organizatori i ushtrisë dhe Xhandarmërisë. Me ardhjen e gjermanëve në Shqipëri, tregon gjeneral Gustov, Balli Kombëtar u armatos dhe u organizua dhe pjesërisht u furnizua me ushqime nga ushtria gjermane, e cila mund të ketë shpërndarë deri 9000 pushkë. Sa herë që ushtria gjermane, bënte ndonjë operacion kundër partizanëve së bashku me ballistët, komanda e Operacioneve ishte krejt në dorën e gjermanëve. Asnjë operacion nuk mund të

bëhej pa urdhër të komandës gjermane. Urdhërat për këtë operacion jepeshin nga Korporata e XXI-të e cila ishte Komanda e Përgjithshme Gjermane.

Është dhënë një urdhër shifer, që asnjë departament i armatosur shqiptar më tepër së 15 veta nuk mund të lëviste pa lejen e gjermanëve. Kur xhandarmëria Shqiptare donte të transferonte një postë xhandarmërie, nevojitej gjithmonë një leje nga komanda e Korporatës XXI-të.

Gjithë operacionet e komandua gjermane shqiptare kundër partizanëve në Mokër, Gorë, Opar e tjera kanë qenë gjithmonë nën urdhërin e repartëve gjermane. Kur bëhej ndonjë operacion i kombinuar kundër partizanëve repartet gjermane e merrnin urdhërin e luftës nga Korporatës e XXI-të, ndërsa repartet shqiptare e merrnin këtë urdhër nga komanda gjermane, të cilat ekzistonin në çdo prefekturë, me anë të një oficeri ndërlidhës gjerman.

Në shtator të vitit 1944 Mehdi Frashëri, u kërkoi gjermanëve për një ofensivë kundër partizanëve, dhe insiston se operacionet të fillojnë nga Mokra e Berati. Për këtë gjermanët kishin filluar një operacion tjetër, dhe nuk mund të bënin dy operacione përnjëherë, përderisa nuk kishin mbaruar atë që kishin filluar.

Efekti i operacionit gjerman që, partizanët kaluan Shkumbinin nga jugu në veri dhe atje e transferuan rezistencën e tyre. Fondet për vullnetarët që janë paguar nga Komanda e mbrojtjes, sipas gjeneral Gustov ishin 4 milion franga shqiptare Kadri Cakrani, 1 milion, Gjon Mraka Gjoni, 1 milion, Hysni Dema, 600 mijë Isa Manastirlliu dhe Mehmet Alltuni, 80 mijë. Musa Piçani, ka marrë Irfan Ohri, Enver Risilia dhe 800 napolona ari i janë dhënë gjeneralit Fitzthum, për t'i përdorur pagesa të ndryshme.



## KUR ËSHTË BOTUAR PËR HERË TË PARË GAZETA "KORÇA" ?

Gazeta "Korça" numrin e parë të saj e nxori më 28.12.1908 në Korçë. Ajo ishte një e përjavshme politike, letrare dhe tregëtare. Ajo vijoi botimin e saj deri në numrin 53 në 1910-ën. Drejtohej nga Sami Pojani. Kjo gazetë trajtonte nevojat e ngritjes politike-kulturore të popullit, demaskoi synimet shoviniste të kohës dhe politikant antishqiptare. U botua edhe përkthime. Me këtë gazetë kanë bashkëpunuar edhe Mihal Grameno, Hil Mosi dhe Gr. Cilka, etje. Botoheshin edhe shkrime për Pogradecin e Mokrën. Për Korçën kanë dalë edhe gazeta të tjera si "Zëri i Koçës", "Gazeta e Korçës" etj.



# Miku nga Frashëri

-Tregim për ndjenjat e shpirtit dhe besës gorare-

Tregon Ferik Spaho nga Dërdusha:

Po shoqëroja gjyshin me tufën e bagëtive për në malin e Al dumanit. Mëngjesi i asaj dite të bukur pranvere ishte i freskët nga shiu që kishte rënë gjatë natës. Si çdo ditë unë hidhja çantën e bukës krahaqafë dhe në dorë mbaja një sëpatë të vogël që na duhej për të prerë ndonjë degë shkoze apo dushku për të mbledhur dhitë kur përhapshin larg nesh. Gjyshi ecte para tufës, duke fishkëlyer ose duke u folur dhive në gjuhën e bariut. Nga anash qëndronin dy qentë e tufës, Baloja dhe Zizojja. Sa lezet kishte kishte gjyshi mes dhive! Kisha qef të shikoja.

Pasi lamë fshatin hymë në thellësi të pyllit. Dhitë u shtruan mirë në

kullotë. Gjyshi më tha që të ulesha pranë tij se diçka do më tregonte. Ai vështronte një lis të vjetër poshtë nesh dhe psherëtinte. Unë u ula pranë tij dhe po e vështroja me habi. Filloi të më tregonte. Kur isha sa ty bir, atje tek ai lis i vjetër kam takuar tre burra që edhe sot i kam para syve. Dielli ishte në të perënduar dhe qielli flakëronte në rruzullim. Po afrohej mbrëmja dhe unë drejtova dhitë për nga fshati e po rrija mbështetur në trungun e lisit. Befas më dolën tre burra të mëdhenj si këta lisat që sheh këtu. Një cast mbeta i hutuar dhe të them të drejtën u tremba. Dy nga ata kishin veshje xhandari dhe mbanin në krah nga një pushkë të gjatë. Ndërsa i treti kishte veshje të thjeshtë dhe mbante në dorë një çantë me pupla si ato të levendeve.

Ai më foli me një zë të ëmbëldhe tingëllyes. "Eja këtu o trim, mos ki frikë! Jemi miq e jo nga ata që mendon ti." Unë u afrova ngadalë, u dhashë dorën dhe po i vështroja në sy të tre. Burri që më foli sikur më ngrohu shpirtin dhe frika dalëngadalë kaloi. Ai kishte flokë të zes e të derdhura, të cilat i binin mbi ballin e gjërë. Kishte pak mjekër të ashpër, por të lezetshme, që i varej si kurorë. Ai më pyeti se a kishte ndonjë rrugë më të shkurtër që të çonte në fshatin Osnat. Unë fillova t' u tregoja rrugën e në mëndje gjykoja ç' të ishte vallë ky njeri? Pasi ndoqa dhitë me sy pashë se ato ishin vargosur në drejtim të shtëpive, u thashë të tre burrave se do t' i çoja unë deri afër fshatit. Burri që më rrinte afër më lehtëtoi flokët e më tha "Qenke trim e i besës, o djalë!" Unë sikur u burrërova dhe e pyeta: "Nga jeni ju zotëri?" -"Jam nga Frashëri, -m' u përgjigj, -ndërsa këta të dy janë nga Korça."

U nisëm të katër. Ecnim nëpër pyllin e dendur me drurët e gjetë degët e cilave na preknin kokën, aroma e trëndelinës na ngacmonte flatrat e hundës dhe ajri i freskët na mbushte mushkëritë. Pasi bëmë një orë rrugë dolëm në një kodër ku dukej Osnati. Kishte rënë muzgu i mbrëmjes dhe hëna filloi të shpërndante ndriçimin e saj marrë borxh nga dielli që kish perënduar. Nëpër shtëpitë e fshatit filluan të ndizeshin kandilët. Drita e zbehtë dallohej nga dritaret e vogla si frëngji të shtëpive. Nga larg dukeshin si xixël-lonja të mëdha, me një bukuri të mahnitshme. Burri me mjekër e flokë të zeza ndaloi dhe po vështronte gjithandej.

Diç bisedoi më dy të tjerët, pastaj u kthye nga unë e më tha.

"Faleminderit, djalos për ndihmën që na dhe! Tani ktheu në shtëpi se të se të presin. A ke frikë rrugës?" "Jo i thashë unë, -jam mësuar të udhëtoj natën."

U përshëndeta përzemësisht dhe mora rrugën për në shtëpi. Nuk më hiqej nga mendja ai njeri me pamje të çuditshme, por me sjellje e kulturë të paparë.

Tregon Çelnike Maxhari nga Osnati:

Sa herë shikoj në vathë nusen e djalit tek mjet bagëtisë më kujtohet ime vjehërë që më ka treguar, se kish derdhur vedrën e qumështit nga zëri i fortë i të shoqit.

Ishte mbrëmje. Fshati ziente nga

tingëllimat e zileve dhe këmborëve të bagëtive që vinin nga mali. Vathat ushtonin nga blegërima e kecape dhe e qingjave, që prisnin me padurim gjirin e mëmave për të pirë qumështin e ngrohtë.

Unë me tim shoq morëm vedrat dhe po rrinim në oborr para shtëpisë. Hëna ndriçonte me rrezet e saje çdo gjë dukej si në pëllëmbë të dorës.

Erdhën bagëtia. Si i futëm në vathë fill-ova të mjet bagëtisë një e nga një, kurse im shoq qëndronte te vatha e shqerave për t' i lëshuar sapo të mbaroja mjetjen. Papritur u dëgjua një zë burri që vinte nga ana e përroit. "O i zoti i shtëpisë a do miq!" Në këtë cast u dëgjua zëri i lartë i tim shoqi: "Bujrum, o miq, e urdhëroni brenda. Dera është e hapur pa çka se është natë".

Unë e kisha humbur fare toruan. Edhe pse isha mësuar me zërin e tij, kësaj here diçka shprehte e që mua më bëri përshtypje. Im shoq thurri Lamen, djalin tonë, dhe vetë shkoi te mysafirët. Si u përshëndetën i ftoi në dhomën e miqve. Si mbarova punë me Lamen shkumë dhe ne t' i takonim. Kur hyra në dhomë ata u ngritën në këmbë. Jo vetëm veshja e veçantë e pamja e tyre, por dhe ky gjest më bëri përshtypje. Nuk ndenja shumë se im shoq më vështroi në sy, gjë që do të thoshte se duhej të bëja gerasjen. Mora shishen e rakisë në dollap e shkova në korridor të mbush gotat që kisha lënë në tabaka. Pas mirëseardhje që u uroi im shoq, i pari e mori fjalën burri me mjekër e flokë të zes, më pas dy të tjerët.

Mbasi uruan dola për të përgatitur tryezën. Brenda vazhdonte biseda e ngrohtë me miqtë. Si i kisha bërë gati të gjitha, hyra brenda shtrova shtrova sofërën e miqve dhe radhita pjatat mbi të. Ata u vendosën rreth saj dhe nisën një muhabet të këndshëm. "Të lumtë dora moj nuse!", - më uroi më i riu prej tyre. Pastaj filloi muhabeti me këngë e raki deri vonë. Biseda kalonte në tema të ndryshme por më shumë për hallet e vatinit. Si hëngrën darkën u shtrova dyshekun që ruanim për kësi rastesh.

Në mëngjes kur Hëna po fshihej prapa malit për t' ia lënë radhën diellit, ata u zgjuan. Dolën jashtë e vështronin në drejtim të Gurit të Kamjes. "Mos u mërzisni o miq se çdo gjë do shkojë siç e dëshironi ju", tha im shoq duke kuptuar se kishin nevojë për udhërrëfyes. Unë u nxora nga një filxhan të madh me qumësht të ngrohtë. Si e pinë, ai me mjekër e flokë të zinj tha: "Qenke grua nikoqire moj nuse e Bariut."

Trgonte Bariu:

Përpara ecte bariu që udhëhiqte udhën, pas tij mysafirët. Fladi i mëngjesit na i freskonte fytyrën, ndërsa mushkëritë mbusheshin lehtësisht me ajrin e pastër të pyllit. Të tre burrat vështronin natyrën e bukur të Gorës dhe kënaqeshin. Troket e këmbëve humbisnin nga cicërimat e zogjve e kënga e qyqes që këndon-te me ëmbëlsi. Pasi ecëm në orë rrugë arritëm në një shesh të bukur ndanë Gurit të Kamjes. Aty miku i parë me mjekër e me flokë të zes, më tha të ndaloja. Bara si më thanë dhe po shikoja nga ai. I pari erdhi mjekroshi pastaj dy të tjerët. U ulën në barin e butë që bleronte dhe drodhën nga një cigare duhan. Unë qëndroja në këmbë duke i vështruar të tre. Mjekroshi nxori nga çanta një fletore dhe një kalem e filloi të shkruajë. Nga mërmëritja e tij dëgjova këto fjalë: "Ëkisha dëgjuar Gorën por tani që shke-la i njoha dhe njerëzit e saj, që paskan qenë sa trima aq dhe bujarë e besnikë."

U nisën në drejtim të maleve të Mokrës. Unë lidha kuajt njëri pas tjetrit dhe u nisa për në fshat. Kur mbërrita kish vajtur dreka. Më vonë do mësonim se ai burri me pak mjekër e me flokë të derdhura mbi ballë, kish qenë patrioti i nderuar, Avdyll Frashri. Pa e ditur kishim pritur e përcjellë një mik të Rilindjes së Madhe Kombëtare.

ÇLIRIM SPAHO

Mokra në histori:

## 7 Marsi i vitit 1944, rrethimi dhe lufta e Dunicës!

Bashkëbisedim me 90-vjeçarin Neim Agolli, si dhe me Myftar Spahiun

(vijon nga faqja 1)

- Cili është mendimi e njohja juaj, për forcat dhe çetat e Ballit?

- Nga disa çeta që numuronte Balli, çeta më e keqe e ballistave ishte ajo që drejtohej Shefqet Blloshmi, vëllai i Hakiut, si dhe e djalit të Hasan beut të Velçanit, të cilët u gjykuan dhe i vranë këtu në Dunicë, nga Batalioni Partizan i Mokrës dhe nga forcat e Brigadës së Parë Sulmuese që ardhën në mbështetje të tyre.

Në përbërjen e forcave partizane të ardhura nga Brigada e Parë të cilat ardhën nga fshati Llëngë, mbasi morën njoftim nga Neim Xhaja, kishte në përbërjen e asaj më kryesorët Tuk Jakova, Panajot Plaku e shumë të tjerë. Mbas rrethimit të fshatit, Hakinë e ka arrestuar dhe e ka çarmatosur një partizane, e cila quhej Emine. Ajo, si e çarmatosi Hakinë, ia mori më pas çantën që mbante hedhur në krah, si dhe automatikun e Komandantit të forcave të Ballit. Haki Blloshmi ishte një burrë i madh në trup i pamëshëm dhe i shkolluar jashtë. Si e çarmatosën, e sollën në shtëpinë tonë, veç grupit të shoqërimet. Ai shoqëohej edhe nga Panajot Plaku. Nëna ime quhej Vaçe. Vaçja ishte e motra e Mersin Muços nga Trebinja, i cili kish studiuar në Itali që në atë kohë dhe më pas kish qenë me bandën frymore në Tiranë, në kohën e Zogut.

Aso kohe ajo ishte kryetare e Këshilli të Gruas të LANÇ për fshatin. Ajo i ngjiti në konakun e ndodhur në katin e dytë të shtëpisë. Nëna ime u thotë partizanëve që ta lidhnin Hakinë, se paraqiste rrezikshmëri dhe mund t' i rrëmbente ndokujt ndonjë automatik e mund të hapte zjar e të derdhej gjak e ai mund të shpëtonte e të largohej, në rast se do mundt të çante rrethimin.

Tuku i thoshte dajos, Mersinit, i cili kish qenë pak kohë me Ballin. "Ti Mersin e kuptove shpejt dhe e more këthesën në kohën e duhur. Hakiu u thoshte partizanëve të Brigadës së Parë, të ndodhur aty në shtëpinë tonë: "Bravo ju qoftë, e zutë gjahun".

Në shtëpinë tonë u shtrua sofrat e madhe atje u ulën dhe 5 vajza që ishin partizane, mbaj mend emërat: Xhije Pëllumbi, Sanda dhe kryesorja ishte Emineja. Me këto u ul dhe hëngri bukë dhe Hakiu. Si u ngrit sofrat atëhere Hakinë e lidhën dhe e ulën të Xhamija. Atje Hakiu ju thur edhe i këndohej kjo këngë: "Atje poshtë tek Xhamija/ do të t' i vejë yjet Partia".

Kur i çuan të xhamia, atje gjetën të lidhur dhe Bamin e Trebinjës, Xhelo Selca, Shefketi i vëllaj i Hakiut dhe Sadik Turtulli. Ndërsa 11 ballistë të tjerë ishin futur e mbaheshin në xhami brënda. Në atë kohë hoxha i fshatit ka qenë Merkë Spahiun. Kur e suallë Hakinë e vendosën përpara Tuk Jakovës, Panajot Plakut, Misto Treska, ish-komisar i bataljonit, Tele Baci, ish-Komandant i batalionit, Pilo Pelisteri, ishte operativ i batalionit. Hakinë si e suallën e vendosën me ata katër të tjerët dhe më pas Tuku tha: "Foli Hakiut, o Misto, se ne kemi ardhur në ndihmë të Batalionit të Mokrës. Ju e njihni më mirë e në daçi i falni në daçi i dënoni!". Pas



Tukut e mori fjalën Misto Treska dhe ai i tha: "Fol, o Haki Efendiu, çfarë ke për të thënë?"

"Po, do flas, - tha Hakiu. - Po t'ju them shokë, unë shokë nuk ju kam, po t'ju them zotërinj juve nuk e pranoni, por unë do flas vetëm dy fjalë. Komandant i Përgjithshëm i këtyre çetave jam unë, për të mirat e të këqijat që këta kanë bërë, jam unë përgjegjës, prandaj nga ju kërkoh që këta shokë të tjerë t' i lironi. Këto fjalë të Hakiut nuk u morën parasysh fare, ata u pushkatuan të pestë.

Të katërt të tjerët ranë me fytyrë në baltë, Hakiu ra këmbëkryq,

dukej si i gjallë. Partizanët i thonë komisar Misto Treskës që t' i lejon-te t'ua merrnin rrobat. Bami i Trebinjës kish qenë i gjallë dhe atëhere u qëllua dhe e vranë për së dyti.

Refat Belba, ishte fshehur në kasollen e Maliq Spahiut. Ai ishte nga Skroska, edhe ai ishte nga krerët kryesorë. Si e zbuluan e ngjitën dhë atë te Xhamija dhe atje e pushkatuan, duke e çuar numrin në gjashtë të pushkatuar. Gjatë asaj ditë u kërkuan për t' u pushkatuar Skënderi i Duros nga Velçani, i cili ishte dhe i nipi i Hakiut, Samiu i Demkës së Velçanit që ishte dhe i nipi i Hasan beut dhe vetë Demka të cilët ishin fshehur në plevicën e bagëtive nga Sali Sofi, i zoti i asaj shtëpie. Në mbrëmjen e asaj nate, është vranë në Dolist nga ballistët Kurti Haxhillari. Partizanët vranë edhe 2-3 ballistë të tjerë, të cilët ishin Sabi Blloshëmi, Lik Bishtou e një tjetër.

Në mbrëmjen e asaj dite në shtëpinë tonë, (shën i autorit) shtëpia e Tekiut, Neim, Dilaver e Nexhat Agollit, erdhën 32 partizane të cilët ishin nga Brigada e Parë dhe Batalioni i Mokrës. Nga më kryesorët ishin Tuk Jakova, Panajot Plaku, Emineja. Nga Batalioni i Mokrës ishin Tele Baçi, komandant, Misto Treska, komisar, Zyko Kalivaçi, Nesti Nase, Isuf Kambo, Feti Smokthina, Nexhat Tirana, Koli Shuke, Nuçi Tira, Llazi Angele etj.

Për tërë atë kallaballëq therëm një dhi. Në atë darkë Tuku i thotë Mersin i Pasho Muços, dajos se juve e kini ballin me nder e kuptuat në kohë dhe u lidhe me në të lumtë. Më pas ranë të flenë, të nesërmen e ditës tjetër, pasi hënër mëngjez, u ulën poshtë te Xhamija dhe muarën ata 11 ballistë që mbaheshin aty dhe u nisën për lart në breg të Osnatit. Para nisjes mësuar se atje në xhami ishte i fshehur dhe një ballist, ishte ngjitur në majë të minares, i cili doli në minare dhe tha: "Shokë, mua ballistat më morën me forcë, prandaj kam një rrixha, të më falni jetën, ose unë do hidhem prej këtu. Atëhere komandanti Tele Baçi i tha të ulej se e kishte jetën të falur, se as nuk je nga ata burra që hidhesh ti.

Sikurse tregohet se ka ndodhur me papa Kostandinin Mokrarin nga maja e kësaj minareje. Atij iu kërkua nga pushtuesit turq të ndërronte besmin, por ai e përbuzi e përbuzi e refuzoj kërkesën e më pas u hedh nga maja e Minaresë, dikur Kisha Mitropolitit e gjithë Mokrës, duke u martirizuar për Atdhe e besimin të krishterë nga ajo minare 500-vjeçare, pa iu nënshtruar osmanllinjëve. Më pas ai u varros me nderime të mëdha nga gjithë gjithë Mokra, atje në vëndburimin e Dedelusë në Kozic e më pas u shënjtërua e u shpall Dëshmor i Kishës e Shënjtor në emrin Shën Kostandin!

Nga ata të 11 ballista e mbullur në xhamisë, 6 gjashtë i vranë në vendin e quart në Rrirat dhe 5 pesë të tjerët lart në Breg të Osnatit, Ndër ata ta vranë ishte dhe Adem Kapri, i biri i të cilit, Shabani, ishte partizan në Brigadën e Parë. Në këtë luftim forcat e Ballit morën një goditje të rëndë e shkatërrimtare që ndikoi në gjithë vëndin. (vijon)

Intervistoi: KOCO PIHONI

# Këngë epike për një shqiptar të vërtetë

Bisedë me miqtë për tabllonë "Oborr poradecar" e piktorit Gjergji Lako

Nga Xhevahir SHTUPA

## 1. Hyrje

Kompozimi në pikturë "Oborr poradecar", është realizim i vitit 2006 dhe është ekspozuar për herë të parë në "Ekspodialog", ekspozitë e përbashkët e piktorëve Anastas Kostandini (Taso) e Gjergji Lako me titullin "Liqeni i ëndërrave" në Galerinë e Artit të Qendrës kulturore "Lasgush Poradeci".

Tematika e kësaj tabloje është krejt e veçantë nga punët e tjera të piktorit Lako. Kompozimi evokon të vërteta historike. Kemi një mjedis real e personazhe të njohur historikë. Evokohet tradita. Ka një përmbajtje atdhetare e shoqërore. Njëherësh apelohet për reflektim; kuptimi i kohës (në të cilën jetojmë) e i detyrës. Të gjitha këto piktori i shpreh bukur me anën e figurave të përdorura e vendosjen e tyre.

Në qendër të tablosë shohim portën që është e hapur. Të zotët e shtëpisë sikur na thonë: "Urdhëroni! Mirë se erdhët!"

Dhe ne gjendemi në oborrin e kësaj shtëpie mikpritëse. Ndjehe miqësi, si në shtëpinë tonë. Bisedojmë...

Piktori sikur na thotë: "I vogël ky oborr, por ka rritur një njeri të madh. Për më shumë shihni (kundroni) objektet. Mund të pyesni edhe Dr. Jovanin. Ai ju ndihmon me librin e tij." Kaq. Piktori hesht. Flet piktura. Flasin figurat. Ne duhet të kuptojmë, të meditojmë e më në fund diçka të mësojmë.

## 2. Çelësi i të kuptuarit

Për të realizuar të kuptuarit e përmbajtjes së tablosë do të vështrime me vëmendje elementet përbërës të saj; figurat, vendndodhjen e marrëdhëniet mes tyre, duhet të kuptojmë alegorinë e gjuhën e simboleve.

Në plan të parë oborri (kujo titullin!) i shtruar me plloça e buti i verës. Verë e vjetër poradecare për të pirë të zotët e shtëpisë, por edhe miqtë.

Sa për miq; kanë shkelur shumë në këtë oborr, ka pritur shumë kjo shtëpi. Ja, dhe shtëpia, në të majtë të tablosë. Në të djathtë, një pjesë e avllisë që rrethon oborrin dhe në qendër porta me dy kanata.

Pragu i gurtë i kësaj porte është pragu ku mbaron Vatra e fillon Bota. Vatra na rrit e na përgatit për Botën. Duke dalë nëpër këtë portë, njerëzit e kësaj familje lidheshin (komunikonin) me fqinjët, me qytetin e më tej me gjithë Shqipërinë (vendin) e Botën.

Miq të e nevojtarët që janë futur në këtë portë, që kanë kaluar nëpër këtë oborr i ka pritur kjo shtëpi në Vatrën e saj. Aty, ata kanë gjetur ngrohtësi (bujari e dashuri), kanë gjetur mirëkuptimin e kanë marrë kurajo e guxim për të përballuar Jetën, kanë gjetur Besën e kanë ushqyer Shpresën.

Në njërin kanat të portës (brenda) është pikturuar A. Ajnshtajni.

Kanati tjetër qëndron i hapur.

Jashtë, pas avllisë, dy qiparisa që lartohen drejt qiellit.

Po ai që na vështron nga lart (nga qiparisi) cili është?

## 3. Protagonisti

Arti i vërtetë, përveçse të fal kënaqësi estetike, të zgjon mendime, të ve në kërkim të së vërtetës jetësore e të kuptimit të saj e pastaj duke kuptuar esencën ideore të shtyt të ndjesh e të reflektosh.

Mjeshtri Lako, i nisur nga fakte jetësore, ka ditur, që duke evokuar një familje poradecare me emër e një bir të shquar të saj që arriti në majat e shkencës së mjekësisë (për kohën kur jetoj) të arrijë në përgjithësim ideore e artistike. Për të kuptuar



tuar të përgjithëshmen do të nisemi nga e veçanta, nga fakti. Shtëpia, që shohim në tablo, është e familjes Basho.

Nga kjo familje, bartëse e traditave më të mira kombëtare kanë dalë njerëz punëtorë, më së shumti mësuesë e mjekë të mirë e të zotë. Por ai që, siç këndon Lasgushi, "...Puthi ballin e lavdisë,..." është U.M.Dr. JANI BASHO (1892-1957)

Ky është fakti. Fakt historik. Jani Basho, personalitet i shquar i kulturës, shkencës (mjekësisë) dhe i historisë sonë kombëtare. Ky është personazhi kryesor i këtij krijimi artistik, i këtij kompozimi në pikturë nga mjeshtri i penelit GJ. Lako.

I frymëzuar nga ky personalitet, piktori ka arritur të realizojë një vepër arti me vlera të spikatura për të cilat do të bisedojmë pas pak, pasi të njihemi me protagonistin tonë.

Titullin U.M.Dr. "Unicus Medicus Doctor" (Mjek i Veçantë), titull që jepej shumë rrallë për të huajt, studenti poradecar Jani Basho e fitoi pas përfundimit me sukses të Fakultetit të Mjekësisë (verë 1921) dhe të specializimit të përgjithshëm në 4 degë (pranverë 1924) në Universitetin e Vjenës.

Informacionin më të plotë për këtë burrë të shquar e marrim nga libri:

"Jovan Basho; Sa kam shpirt, kam shpresë", U.M.Dr. JANI BASHO

(Botues: Shtëpia e librit OMBRA-GVG, Tiranë 2002)

Libri përmban dokumente autentike, publicistikë nga Jani Basho, rrëfime për punën e karakterin e tij, analiza të autorit Jovan Basho etj.

Lexuesi mund të mësojë shumë:

Së pari; për jetën e vështirë të femijërisë, por edhe mbështetjen ekonomike të vëllait të madh Gjokë Bashos në rrugën

e shkollimit të Janit.

Së dyti; për zellin, vullnetin e këmbënguljen që ka treguar vetë Jani duke mbaruar me rezultate të shkëlqyera të gjitha kategoritë e shkollave.

Së treti; për veprimtarinë e shumë-anëshme atdhetare e veçanërisht për shkërimet e tij publicistike në revistën "Dialëria" të studentëve shqiptarë të Vjenës (vitet' 20 të shekullit të kaluar), shkrime që i përshkon shqetësimi për Atdheun e besimi në orientimin nga Perëndimi. Në këto shkrime të habit erudicioni i tij e forca argumentuese që e bëjnë Dr. Jani Bashon një intelektual të dorës së parë. Shkrimet e tij janë aktuale e përcjellin mesazhe edhe për sot e në të ardhmen.

Së katërti; ne mësojmë se ideatori e kontribuesi kryesor në ndërtimin e Spitalit Civil e Spitalit Ushtarak në vendin tonë (në kohën e Mbretërisë shqiptare) paska qenë Jani Basho.

Së pesti; mësojmë se Dr. Jani Basho është themeluesi i obstetrikës dhe i gjinekologjisë shqiptare në baza shkencore.

Së gjashti; mësojmë për kontributin e tij të shkëlqyer si pedagog e hartues tekste për mjekësinë.

Kudo që punoi, ai tregoi humanizëm, qytetari e aftësi profesionale në shkallën më të lartë.

Qëndroi gjithnjë pranë Vatrës e pranë Punës.

Në pashëniën e librit autori pyet e përgjigjet se ku i ka rrënjët formimi i këtij personaliteti e kush ndikoi në formimin e karakterit të tij, që ai të "rritet dhe mbetet thellësisht e thelbësisht shqiptar."

Para së gjithash familja që i mëkoi traditën dhe një ndjenjë detyre shumë të fuqishme. Pastaj burrat e ashpër, por punëtorë e të nder-

shëm nga fshati Homçan i Mokrës, miq të të vëllait, mes të cilëve ai kalonte muajt e verës. Një botë e gjallë, fisnike dhe e fuqishme që Jani nuk e harroi gjithë jetën.

Si homçanak (mokra) mua më vjen mirë për këtë pohim e vlerësim.

Më tej akoma, arsimimi në shkolla serioze, shokët e profesori.

U.M.Dr. Jani Basho punoi e zbatoi Betimin e babait të mjekësisë, Hipokratit.

## 4. Dr. Jani Basho e Rilindësit

Ideologu i madh i Rilindjes sonë kombëtare Sami Frashëri në librin: "Shqipëria-ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?"

(Botimi 1, më 1899, në Bukuresht)

Kreu III, pika XIII- "Diturija" thekson: "Në ka një gjë, për të cilën shqiptarët duhet të kujdesen me të tepert, ajo pa ndryshim (dysim) është diturija."

Dhe më poshtë Samiu shkruan mbi nevojën e hapjes së shkollave në gjuhën shqipe.

(Sami Frashëri, Vepra, vëllimi 2, faqe 76. Botimi i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 1988)

Ja se çfarë shkruan studenti shqiptar i Vjenës Jani Basho në N=1 të revistës "Dialëria" më 1920:

"Shoqëria e studentëve shqiptarë "Albania" është e sigurtë se gjuha shqipe dhe shkollat shqipe janë ato, të cilat do t'i bëjnë të gjithë shqiptarët, shqiptarë të vërtetë dhe Shqipërinë një shtet me themele të paturdur."

(Jovan Basho, Libri i cituar, faqe 123)

Po më 1920, në shkrimin "28 Nëntor" (revista "Dialëria" N=8) Jani thekson:

"Qëllimi i rrojtjes së Shqiptarëve të vërtetë është:

Zhvillimi i gjuhës sonë amtare, përparimi i shkollave shqipe dhe i kulturës sipas kërkesave të shekullit XX." (Po aty, faqe 137)

Për rëndësinë e gjuhës Samiu konkludonte: "Gjuha është më e para dhe më e madhja shenjë e një kombësie."

Edhe Jani Basho për gjuhën, që është themeli e simboli kryesor i kombësisë, shkruan: "Gjuha është për jetën kombëtare të një populli, si gjaku për jetën e një njeriu." Më pas ai vazhdon: "... një popull pa një gjuhë të zhvilluar nuk mund të lartësohet."

(Nga shkrimi "Gjuha" në revistën "Dialëria" N=17, faqe 2-4, 1922.

Po aty, faqe 169)

Rilindësit tanë, që, siç shkruan Dr. Vladimir Poçari në shkrimin "Po a(kur) do të bëhemi vallë?!", kanë qenë shqiptarët më të mirë, më të drejtë e më të rrallë. (gazeta "Ballkan", 14 janar 2007, faqe 10).

Ata luftuan me të gjitha mjetet për çështjen e Pavarësisë dhe sytë i kishin nga Perëndimi. Edhe Jani ynë është ndër vazhduesit e drejtpërdrejtë të ideve të rilindësve. Në shkrimin "Orientimi nga Perëndimi shpëtimi ynë i vetëm", botuar në revistën "Dialëria" N=15-16 faqe 1-3 në vitin 1922 ai apelon fort:

"Djalëri shqiptare, koha bërtet për një ndërrim të madh politik, social dhe kulturor në atdheun tënd, koha bërtet për orientimin tonë nga Perëndimi".

(Vepra e cituar, faqe 168)

Rilindësit dhe pedagogjia tradicionale theksojnë rolin parësor të familjes në dhëniën e edukatës.

Ja, ç' thekson Jani:

"Edukimin e shtëpisë nuk mund ta zëvendësojë as një edukim tjetër". (faqe 127).

Nga libri në fjalë po veçojmë:

Jani Basho vlerësonte:

1... idealizmin, altruizmin e njerëzimin si themelet e qytetërimit. (faqe 165)

2. Karakterin si stolinë më të bukur të njeriut. (faqe 167)

3. Motua e studentëve shqiptarë të Vjenës ishte “Sa kam shpirt, kam shpresë”.

(“Dialëria” N=1, faqe 1-2, 1920)

Sepse ideali i studentëve shqiptarë është shpresa, shpresa e madhe për realizimin e ëndërrave të tyre në një Shqipëri europiane. (faqe 34)

U njohëm kështu me protagonistin e kësaj vepre arti, me të zotin e “oborrit” dhe të kësaj shtëpie, me Dr. Jani Bashon.

Tani të njihemi me mikun e tij (personazhin tjetër të rëndësishëm i tablosë).

### 5. Miqësia me Ajnshtajnin

Albert Ajnshtajni (1879-1955), shkencëtari më i madh i shekullit XX, themeluesi i Teorisë së Relativitetit, fitues i çmimit “Nobel” në fizikë (1921).

Në librin e Jovan Bashos pohoet miqësia e letërkëmbimi i Dr. Jani Bashos me këtë gjeni të shekullit. Ajnshtajni, sipas Jovan Bashos, ka bërë një udhëtim të fshehtë në Shqipëri në pranverën e vitit 1931, kohë kur ai ndiqej nga nazistët gjermanë për shkak të origjinës së tij hebreje. Mbrojtja dhe shpëtimi i hebrenjëve para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore është një fakt, një e vërtetë që na bën ne shqiptarëve krenarë përballë historisë, tregues i shpirtmadhësisë e i humanizmit tonë.

Ekspertja e çështjeve të Ballkanit, Zonja Dio Guardi, duke folur për këtë problem thekson se shpëtimi i hebrenjëve në Shqipëri gjatë Holokaustit është një rast i mirë për shqiptarët që ta tregojnë historinë e tyre nga një pikëpamje shqiptare dhe të theksojnë këtu Besën, virtytin e fjalës së dhënë.

Gjatë intervistës së dhënë nga Nju-Jorku në “Zëri i Amerikës” për këtë fakt ajo përgjigjet se ky nuk ishte një akt fetar, ishte një akt shqiptar.

Po në këtë intervistë, Zonja Dio Guardi shpreh mendimin se jo të jashtëm të interpretojnë historinë e shqiptarëve, por vetë shqiptarët duhet të tregojnë historinë e tyre. (Shih gazetën “Republika”, 4 gusht 2010, faqe 10)

Si shqiptar më vjen mirë që kjo Zonjë e nderuar vlerëson Besën që ne kemi.

Ajnshtajni, me atë shprehje të ëmbël të fytyrës së tij, i thjeshtë e që bënte humor e qeshte me pasion kur bisedonte me familjarët e miqtë, por edhe me shprehjen e menduar e meditative kur hynte në diskutime për probleme shkencore, ...Kur meditonte për Kozmosin e kërkonte të zbulonte misteret e tij.

Sipas Ajnshtajnit, tek ndjesia e misterit, si emocioni më i bukur dhe më i thellë që mund të ndiejmë, qëndron bërthama e çdo arti dhe e çdo shkence të vërtetë.

Ajnshtajni në Besën e shqiptarëve... Portreti i tij, aty brenda portës së oborrit është një alegori, është një simbol ashtu si libri e globi.

Porta e shqiptarit gjithmonë e hapur është për miqtë.

### 6. Simbolika e figurave

Piktori ka mjet shprehës figurën, ngjyrën. Aq më shumë në një tablo kompozicionale ku çdo figurë diçka duhet të thotë. Të gjitha së bashku, ku e si janë vendosur ndihmojnë piktorin për të shprehur përmbajtjen, për të dhënë një ide.

Të dashur miq, tani pasi kemi mësuar diçka mbi protagonistin tonë e mbi mikun e tij të madh A.A. le të kudojmë (e të meditojmë) për objektet (figurat) e tablosë.

Jemi bash në mes të oborrit.

#### 1.A. Ajnshtajni;

Kundrojmë me vëmendje portretin e tij. Sa i bukur!

I thjeshtë si e vërteta. Sa ëmbëlsi ka në fytyrën e tij! Na vështron me mirënjohje e në emër të të gjithë hebrenjëve që u mbrojtën, këtu në Shqipëri, nga nazizmi sikur bëhet gati të flasë e të thotë: “Faleminderit shqiptarë! Besa juaj na shpëtoi.”

2. Në murin e avllisë një copë suvaje ka rënë dhe ja; para nesh koka e një skulpture antike, simbol i bukurisë. Ndjenja e së bukurisë e trashëguar në genin e kësaj familjeje poradecare, në genin shqiptar, në racën tonë ilire.

Koka e skulpturës antike (klasike) është në mur. Ngjan sikur ka rënë një pjesë e suvasë e befas ne shohim këtë bukur. Si, këtu paska qenë?! E ne e kemi kërkuar gjetkë (larg)!

Nuk mendonim se e paskemi këtu, në themelet tona.

#### 3. Buti i verës; tradita e trashëguar brez



pas brezi si kudo, por edhe këtu, “Në një cep të Ilirisë së Poshtme”, siç do të shkruante M. Kuteli. Këtu në Enkelinë e mbret Bardhylit ku vera bëhej edhe nga mjalti. Vera, ushqim i mirë i trupit. Prania e butit të verës në këtë pikturë mendoj se simbolizon mikpritjen (bujarinë), por edhe punën, mjeshtërinë, vreshtarinë. E vreshta s’bëhet vetë. As me urata. “S’bëhet vreshta me urata, por me kazma e lopata,” -thotë fjala e urtë popullore. Shohim edhe një shishe verë që po zbrazet në but. Ç’do të thotë piktori me këtë detaj artistik? Rikthim në traditë? Po.

#### 4) Libri, ushqim i mirë i mendjes.

Libri simbolizon ndjenjën arsimdashëse, dashurinë për shkollën, për mësimin, etjen për dije. Libri, simbol i diturisë, i pikturuar, jo në bibliotekë ose mbi tavolinë, por, këtu mbi gurin e madh të oborrit mendoj se ka disa nënkuptime.

Nënkuptimi i parë; kjo familje e do shkollën.

Megjithë kushtet e vështira të krijuara pas vrasjes së të atit, Gjokë Basho (vëllai i Dr. Janit) edhe pse s’ishte më shumë se 18 vjeç, mendon e gjykon si një burrë i madh në moshë, fisnik në shpirt e largpamës. Merr vetë përsipër barrën e familjes e vëllanë e vogël e nxit dhe e ndihmon të shkollohet.

Nënkuptimi i dytë; (që plotësohet nga prania aty e globit) Jani Basho që një nxënës e student i shkëlqyer që synoi e arriti majat.

Ai trashëgoi e manifestoi dashurinë për dijen (kulturën) e punën (ndjenjen e detyrës). Nënkuptimi i tretë; (më tej akoma):

Jani Basho mbetet një model pozitiv.

Ai ishte një shqiptar i madh, një shqiptar i vërtetë që, po të shprehemi me gjuhën e Samiut, u përpoq për mbrohtësinë e mëmëdheut duke i shërbyer në shumë drejtime, por kryesisht përkushtimin e tij maksimal e pati në shërbimin shëndetësor.

“Shëndeti është e para, bir,” -thonë pleqtë.

Jani Basho është një pasqyrë ku ne mund të shohim modelin e karakterit.

Ne kemi se ç’ të mësojmë nga ai; për punën, për përkushtimin profesional, për qytetarinë e për karakterin e tij të rrallë.

Jeta e Puna e tij është për ne një libër gjithmonë i hapur. Ky është edhe mesazhi kryesor që përcjell piktori.

5) Globi- Globalizmi- një dukuri e kohës së sotme. Globi është pikturuar mbi librin.

Dijet (librat) na bëjnë të mundur të njohim Botën (më tej Universin) e ne të jemi pjesë e qytetërimit evropian e botëror... Globi rrotullohet.

Ta lëmë globin të rrotullohet megjithëse ai rrotullohet pa na pyetur ne e pa iu marrë mendtë fare e ne, të dashur miq, të vështrojmë jashtë avllisë...

1) Qielli është jeshil, (është shpresa jonë), me shtjella resh të bardha. Shohim zoj në fluturimin e tyre të lirë. Matanë avllisë edhe dy qiparis në formë V-je, që ngajnë me dy gishtat e një dore.

2) Mbi portën e avllisë (midis oborrit e hapësirës jashtë, folenë mbi mur, për vështrimin lart, drejt qiellit), Lako ka pikturuar një tjetër figurë simbolike, shumë kuptimplotë; shtërgun.

Shtërgu (lejleku) aty ka folenë e tij Ja edhe

vezët, simbol i fillimit të jetës, që zbardhin.

Meditojmë...Lejleku, zog shtegtar, ky shpend i bardhë e fisnik. Shihni në ç’pozicion, në çfarë çasti e ka fiksuar artisti ynë Lako!

Shtërgu ka zgjatur qafën e tij të gjatë, ka ngritur kokën përpjetë e po vështron zogjtë që fluturojnë lart në qiell. Ngjan sikur po përgatitet, që, nga çasti në çast, të ngrihet vrik përpjetë e të provojë sa lart do të ngrihet e deri ku do të fluturojë. Edhe qielli në këtë pikturë nuk është i kaltër (as gri s’ka pse të jetë). Ai është jeshil. Kjo ngjyrë na e shpie mendimin tek motua e Dr. Jani Bashos dhe e studentëve shqiptarë të Vjenës: “Sa kam shpirt, kam shpresë”.

3) Në njërin nga qiparisat piktori ka përfytyruar Jani Bashon si për të na thënë se ai tashmë është një qiparis, gjithmonë në gjelbërim (metaforë poetike e pikturike njëherësh), me rrënjët këtu në lagjen Burima ku lindi e me kurorë që lartohet drejt qiellit.

Që nga qiparisi (selvia) vështrimi i tij është gjithmonë aty në mes të oborrit të fëmijërisë, por njëherësh edhe mbi librin e globin.

Neve, shikuesve të tablosë, sikur na thotë: “Mësoni e punoni! Njihni Botën e matuni me të, por mos harroni Vatrën!”

### 7. Matematikë

Lejleku që po ngrihet në fluturim është biri i kësaj shtëpie (familjeje) studenti poradecar Jani Basho (metaforë), i cili provoi me sukses fluturimin në qiellin evropian, por nuk e harroi Shqipërinë (ashtu si lejleku nuk e harroi folenë aty mbi portën e oborrit). Në përfytyrimin tonë ai do të jetë gjithmonë aty, mes degëve të selvisë si një ikonë. Piktori njëmend na krijon përfytyrime kaq të bukura! Për të bërë lidhjen e figurave mund të heqim dy vija pingule;

Pingulja e parë; maja e selvisë, balli i Dr. Bashos, suvaja e rënë, në mes të globit, në mes të librit e fundi mbi plloçat e oborrit.

Pingulja e dytë; fillon lart, tek reja më e bardhë, ulet poshtë tek krahu i majtë i zogut që fluturon, vazhdon në qafën e lejlekut, në ballin e Ajnshtajnit e fundi (edhe i kësaj pinguleje) mbi plloçat e oborrit.

Po të nisemi në kahje të kundërt, këto dy vija janë dy paralele që fillojnë këtu në plloçat e këtij oborri e zgjaten lart drejt qiellit. Dy paralele në funksion të një ideje.

Lejleku që këtu u ngrit fluturim, Bashua këtu hodhi hapat e parë në jetë.

Këtë bir, oborri (Vatra) ia dha Botës. Ajnshtajni e globi janë pikturuar brenda oborrit. Shkenca e dija botërore janë nevojë e pjesë e jetës sonë. Ne (shqiptarët) jemi kuriozë e kurajozë që të shohim e të mësojmë ç’bëhet jashtë “oborrit” tonë. Ne kemi kuriozitetin e kurajon që të njohim Botën e Gjithësinë, kemi aftësinë që ti vlerësojmë ato objektivist e ti bëjmë pjesë të mendimit tonë. Globi e Ajnshtajni të pikturuara këtu brenda oborrit këtë kuptim kanë. Por edhe dicka më shumë – vetë Prof. Dr. Jani Basho e ndihmoi shpëtimin e viganit hebre Albert Ajnshtajn kur ai erdhi në Tiranë që të largohej për në Amerikë me pasaportë shqiptare.

Ne i kemi dhënë e i kemi marrë Botës. Edhe tani kemi nevojë të marrim nga Bota, por edhe po i japim. Ky është Integrimi. Shohim edhe një herë drejtzën e parë që fillon tek plloçat, kalon përmes librit, tek globi e përpjetë...

Midis plloçave të oborrit e globit qëndron libri i hapur. Kjo vendosje sikur na thotë se është libri ai që lidh oborrin (Vatrën) me globin (Botën), “Urë-libri”, -siç e quan shkrimtari ynë i madh I. Kadare.

Libri, burim dijesh, por edhe një urë komunikimi mes nesh e qytetërimit evropian e botëror. Vazhdojmë më tej interpretimin tonë.

Po të heqim dy diagonalet që bashkojnë katër cepat e tablosë do të shohim që ato priten, ose më mirë të themi takohen mbi kanatin e hapur të portës, lart m’u aty ku i zoti i shtëpisë e sheh mikun në sy e i uron mirëseardhjen.

Porta e hapur është zemra e hapur, zemra bujare, zemra e ngrohtë.

Libri i hapur (që lexohet) është mendja e hapur, mendja e kthjellët (e ftohtë), është horizont.

Të dyja së bashku janë një mrekulli. Lum kush i ka.

Porta e hapur e libri i hapur janë hapje

për ne, janë simbole të integritit bashkëkohor që aspirojmë. Sa e bukur gjuha e artit!

### 8. Përfundim

Piktori Gjergji Lako në këtë kompozim ka përdorur me mjeshtëri vendosjen e figurave dy nga dy, herë si metaforë e herë si simbol, për të shprehur e shoqëruar ide duke krijuar me to simetrinë, kontrastin dhe së fundi i ka harmonizuar ato si një e tërë.

Ja radha logjike e kuptimit dhe e interpretimit:

1. Shtëpia dhe avllia.

2. Oborri (brenda) me të gjitha figurat (objektet) dhe hapsira (jashtë) me elementet e saj.

3. Porta me dy kanata.

Kjo portë përcolli birin e vet në rrugën e dijes e të shkencës (drejt Evropës e Botës).

4. Portreti i Dr. Jani Bashos (i lartësuar, si për të shprehur lartësinë e tij intelektuale) dhe i Albertit brenda portës.

5. Portreti i Ajnshtajnit e globi (si simbole të vlerësimit tonë)

6. Buti i verës e koka e skulpturës;

(bujaria e bukuria janë këtu).

7. Buti i verës e shishja që po zbrazet aty; (tradita e mirë e rikthimi në të).

8. Libri e globi (si simbole të dijes e njohjes së vetes e botës).

9. Lejleku e zogjtë lart që fluturojnë; (joshja drejt lartësive).

10. Lejleku e studenti poradecar J. Basho (metaforë e paralelizëm figurativ).

11. Dy qiparisat.

12. Dy zogj që fluturojnë.

13. Dy shkallët e gurta tek porta.

14. Dy faqet e hapura të librit.

15. Porta e hapur e libri i hapur

Duke pikturuar në të majtë; shtëpinë, portretin e Ajnshtajnit, lejlekun në fole e zogjtë, e në të djathtë; butin, librin, globin, kokën e skulpturës,

pjesën e avllisë e qiparisat krijohet një simetri e përsosur e së fundi një kompozim vërtet harmonik.

Mendoj se piktori theksin idear e ve në figurën e librit e në ngjyrën jeshile të qiellit (në pjesën mbi portë, mbi folenë e lejlekut).

“Dhe drit’ e diturisë përpara do t’na shpjerë, përpara drejt lirisë”.

(Naim Frashëri)

Piktori komunikon bukur e qartë me ne shikuesit. Vepra përmban tri linja (nën ide) në funksion të një ideje tërësore.

Linjat mendoj se janë:

1. Vatra dhe Bota.

2. Tradita dhe bashkëkohorja (modernja).

3. Dituria e virtyti (inteligjenca e karakteri).

Tabloja evokon... e apelon nevojën për reflektim, për integrim.

Tabloja me përmbajtjen e saj është si një këngë epike thurur për familjen poradecare të Bashovë e për birin më të shquar të saj, Dr. Janin. Kjo këngë evokon trimërinë e këtij burri të ditur, i këndon punën e diturisë së tij. Epikë në pikturë.

Ajo na fton edhe për të reflektuar thellë e sinerisht. Si në një dramë (epike e simbolike brehtiane), duke parë se si vepron protagonistin ynë duhet të pyesim veten: ç’bëjmë ne për të njohur veten? Po Botën?

Sa e si punojmë? A jemi ne shqiptarë të vërtetë si ai? Po kush është shqiptar i vërtetë?

Përgjigjen na e jep Sami Frashëri. Të rilexojmë Përmbledhjen e veprës: “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”?

Ja çfarë shkruan ai si përfundim:

“Kur të bëhenë gjithë shqipëtarët a më të shumtët e tyre kështu shqipëtarë të vërtetë, Shqipëria atëherë është e bërë e e shpëtuatë nga çdo rrezik”.

(Vepra 2, e cituar edhe më lart, faqe 87)

Besojmë e shpresojmë!

Jeta e vepra e Jani Bashos është një pasqyrë viryesh, është një model, një përvojë, një libër i hapur.

Faleminderit që më dëgjuat!

Faleminderit, në më kuptat ç’ju thashë!  
Pogradec, më 09.02.2011

# Kuajt e natës\*

Tregim nga Istref HAXHILLARI

Thoshin se ishte kurvë, po ai e donte. Ja që edhe një femër e tillë mund të duhet, madje marrëzisht. Fjalët e turpshme, zvarritur ngadalë nën zë, nuk e bindnin. Njerëzit i zmadhojnë gjërat, nganjëherë të venë brirë kur nuk i ke, prirë të mos u zinte besë.

Në qytetin e tyre, e shkuara dhe e tashmja përplasheshin në ndeshje të vazhduar, secila me mjetet e veta paqësore. Koha e re luftonte ndershmërisht me autostrada, makina luksi, internet, hotele moderne. Tinëzarja kohë e vjetër fshihej prapa qosheve, rrugicave të vogla me kalldrëm ngrënë nga vitet, bahçeve të qëmotshme dhe sidomos prapa syve mosbesues të njerëzve. Neni jetonte në cep të lagjes së moçme nga perëndimi, afër burimeve të famshme, Fillareta pranë rrugës kryesore në hyrje nga ana e veriut. Apartamenti i saj ndodhej në katin e dytë mbi minimarketin e Kristinës.

Çdo ditë ajo dilte te stacioni i autobuzit në orën shtatë e gjysmë, bashkohej me mësuesit e tjerë, udhëtonte jashtë qytetit. Jepte anglisht në një shkollë rrëzës së liqenit. Zakonisht kthehej rreth orës katër mbasdite. Puna nuk e lodhte, gjithnjë e freskët u fliste me dashamirësi të gjithëve. Buzëqeshja e përhershme, tualet natyror i platinës, ndehej buzëve të brydhëta si qershi. Kur kalonte rrugës, dhjetëra sy binin mbi të.

Forca e magjepsjes që rrezatonte, duke robëruar gjithsecilin, mbetej mister.

Fillareta kishte vithe të bukura, trup të drejtë dhe këmbë të përsosura. Ua kalonte të gjitha vajzave të lagjes, ndonëse në fytyrë nuk qe gjë. Sytë e bardhë larg njëri-tjetrit, hunda e vogël dhe flokët e shkurtër bojëgruri e tregonin femër mesatare. Po kurmi i derdhur, lëvizjet e hijshme dhe sjellja e shpenguar i godisnin meshkujt. Djemtë turbulloheshin, u mbahej goja, nuk dinin të thoshin një fjalë për të qenë, kurse burrave të martuar u mbeteshin sytë, sikur kërkonin të mbushnin një boshllëk të përhershëm.

Verës vishte bluza të hapura me ngjyra të vrara dhe funde të shkurtëra, zbulonte gjer lart këmbët elegante të hatashme. Grave u dukej shumë e dhënëra pas modes. "Femra duhet ta ruajë veten, të mos e tetrojë", arësyetonin mes tyre, po Reta e hajthme, lozonjare nuk pyeste.

Vajzat e sodisnin me kureshtje dhe një lloj frike siç shihen të sëmurët e pashërueshëm. Kaq e mirë dhe lavire? Qeshnin, turbulloheshin e argalisheshin nga fjalët e turpshme, po më tepër u vinte keq për Retën me trup aq të bukur, për t'u patur zili. A nuk kishte mundësi ta hiqte atë njollë?

Ajo nuk fyhej, i shikonte me dashamirësi të gjithë, po aq sfiuese si më parë. Kur e shikonin, gratë përjetonin një gëzim të egër prej fëmijësh noproanë. Mund të thoshin ç'të donin, ajo nuk bënte kurrëgjë, nuk i ankohej askujt.

"Zemra e njeriut është e verbër", mendonte me keqardhje.

Ja kështu qe Reta, me shpirt të lirë, shikonte punën, as bëhej merak ç'thoshin njerëzit. I pëlqente qyteti, liqeni, pulëbardhat, njerëzit pa përjashtim. Nuk dinte të ur-



rente. Askush nuk e dëgjoi të këmbente fjalë të ashpra, apo të zihej. Kur djem të guximshëm e ngacmonin me fjalë të turpshme, buzëqeshite krenarisht, i vështronte me nuanca qortimi të lehtë në sytë e kuluar si lule kumbulle. Të penduar, trimoshët shpartalloheshin.

-Arrat i gjuajnë me gurë, jo shelgjet - bënte shaka Tom Belegu.

-Ke të drejtë xha Tomi, - qeshte ajo plot hare, e mikluar.

Belegu e ndiqte me sy, psherërinte i ngashënjyer. Reta fironte trishtimin dhe brengat e moshës, ashtu si fladi i vjeshtës davarit retë e fillimdimrit.

Ngaqë sillej çlirët, pa komplekse, mësuesja e anglishtes shihej me dyshim. Ndoshta prandaj e quanin të shturur. Shumë syresh qenë të bindur se diçka nuk shkonte në qëndrimin dhe sjelljen e saj.

Retës i pëlqente natyra, aty ndihej e plotë. Hapësirat e mbushnin me frymë, e gazmonin. Pranë liqenit, mes ajrit të bollshëm dhe fushës së gjerë pa kufij, nuk i donte ngushticat, dhomat e mbyllura, motelet, i zihej fryma. Neni e takonte çdo mbrëmje mes plepave gjethegjere dhe akacjeve në rrethinat pranë Qytezës, ku preheshin gjurmët e vendbanimit të lashtë. Drurët e dendur dhe shkurret krijonin intimitetin e dhomës së gumit.

Mbrëmjes së prillit trazuar me shi të imët dhe erë, ai e priste plot ankth. Përthithte polenin e luleve të saçoçelura, aromën e athët të rrugës së lagur prej shiut, dëgjonte fëshfërimën dembele të ujit. Qielli i ngarkuar, varur tejposhtë, lëmonte butësisht faqen e lëngshme të liqenit. Një zog i murrëm, çukiste mbi drurin e mollës përkarshi. Gjithçka e lagësht, rruga, gjethet e rrushit, muret, kaçubet. Në ajrin e mjegulluar, të ngrohtë, taracat e pallateve vezullonin, ndërsa, përmes pemëve, të zinte syri një pjesë liqen gri me ca rrudha të argjendta.

Kur rri dhe përgjon, njeriu fiton një përmasë tjetër me të cilën vëzhgon hollësisht, të përbëndëshme në rrethana të tjera.

Ajo erdhi me çap të shpejtë si era. Drita e zbehtë kapte lakimet e këmbëve, format e gjinjve, ndriçonte flokët në ngjyrën e ndryshkut. Pa thënë asnjë fjalë, Neni e puthi gjatë me gulçima të njëpasnjëshme. Ngjitur pas saj i përcillte papushuar mesazhe në trajtën e përkëdhelive. U rrëkëlljen mbi bar, depërtuan thellë

nëpër sytë e njëri-tjetrit, eksploronin zona të panjohura më parë.

Zgjasnin çastin para se të jepeshin.

-Je kali im i natës, - tha Neni i dalldisur dhe i ra lehtë vitheve të kërcyera. Në heshtjen e virgjër të mugëtirës zëri kumboi si jehonë.

Këndellur, me sy gjysmë të mbyllur, ajo vështronte nga poshtë fytyrën e prushitur të Nenit. Kaloi mjaft kohë, kaq ëmbël, kaq thellë, ngarkuar me emocion, derisa u dhanë të rraskapitur. Ai mbeti shtrirë mbi të dhe dremiti. Reta u drodh nga kënaqësia. Ledhatimet e zjarrta, rënkimet dehëse, vesku i natës dhe muzgu i florinjte shkrire në një, kjo ishte lumturia. Ditën, kur e kujtonte, eksitohej, orët i dukeshin të gjata.

Pothuaj çdo mbrëmje, trupat e tyre kapërtheheshin të ngazëllyer. Loja e kuajve të natës nuk shterte kurrë. Ajo e priste gjithnjë e qeshur, e malluar.

Neni besonte se Fillareta rrezatonte mirësi...

Nga dritarja e raftit kozmetik në minimarketin e Kristinës, ku blinte çdo muaj pastën e dhëmbëve "cherer", Neni pa Retën të ecte ngadalë trotuarit përballë. Pothuaj në të njëjtën kohë dëgjoi zërin e ngjirur si prej burri të Çaçes.

-Ta pish në kupë, po ç'e do, e lëvizur.

-Eh, ajo nuk jeton në këtë botë, - psherëtiu Kristina e gjallëruar përnjëherë.

Pas banakut nga mëngjesi në darkë, Kristi e gjatë dhe simpatike nuk e mbante veten. Flokët e thinjur, rrobat dosido e tregonin më të moshuar. Sytë e vegjël të vëmendshëm regjistronin gjithçka si aparat dixhital. Në dyqanin e saj gjeje përherë një dyzinë grash, që shtynin kohën. Bisedat nuk qenë thjesht kureshtje e pafajshme, ato argëtoheshin me sjelljen e njerëzve. Rrallë i shpëtonin kalimtarët kërkërisë së tyre. Në këtë lloj auditori virtual secila shpaloste aftësitë e veta. Reta ishte pre i lehtë, binte kollaj në lak se nuk bënte asnjë përçapje të mbrohej.

-Shkon me Tom Belegun, - foli Çaçja mbytur, sikur rrotullonte mastik nëpër dhëmbët e rrallë, të ngrënë.

I vetëm në qoshen e minimarketit, Neni u zmbraps a thua e goditën me pëllëmbë. Plaku me atë vajzë të re?

Edhe Kristinës iu duk e tepru-

ar. Çaçja fliste marrëzira.

-Na bëre për të qeshur, - i tha.

-E pashë me këta sy, - u përgjigj Çaçja ngadalë. Përreth endeshin blerësit e rrallë.

-Ku?

-Rrugës së Qytezës. Fare rastësisht dëgjova rënkime femre nga ato, e di ti, pastaj zërin e Tomit: "Kali im i natës".

-Ç' thua moj! - u habit Kristina.

-Kështu i thonë tani, - qeshi me zë të lartë trashaluoja, - edhe unë u cudita.

Neni pagoi dhe iku kokëvarur, i tronditur si kurrë më parë.

"Nuk janë kot", arsyetoi i turbulluar. "Nga e dinë batutën?"

Mendoi të mos e takonte Retën, po shpejt ndërroi mendje.

Ndenji ftohtë, i mërziutur. Po bëhej gati të zbrazej, kur ajo foli krejt natyrshëm, madje buzëgaj.

-Tom Belegu më tha sot, "ku je o kali i natës", - dhe qeshi me zë të lartë.

Neni u shastis.

-Jo, të ka thënë ndryshe, - ironizoi hidhur.

Ajo e shikoi me habi.

-Kali im i natës, - plotësoi Neni në mënyrë cinike dhe provokuese.

Reta u ligështua. Fjalët e lodhën, më shumë se sa e trishtuan. Ajo kishte filozofinë e vet. Gjithkush le të sillej si i pëlqente, asaj aq i bënte. Në donin të merreshin me fjalë, puna e tyre. Dhe ai e dinte, kaq herë patën biseduar. Priti e angështuar me vështrim mbi qytetin indiferent, që shtrihet i përgjumur në këmbët e tyre.

Neni dashuronte për herë të parë, nuk i njihnte femrat. Mënyra si reagoi ajo iu duk e dyshimtë, jo e zakonshme.

"Nuk kundërshtoi, as iku. Si e duroi akuzën e rëndë?"

Mendimet e hallakatura iu ndalën për një çast, po sakaq morën sërish gjallëri, rëndën pas vajzës.

Nga natyra i butë, nuk mbante inat. I hodhi duart në bel dhe u rrënoqeth, Reta qe bërë pjesë e tij. Atë mbrëmje me vesë argendi të lagësht, loja qe mbresëlënëse si ditë e kthjelluar vere pas shiut të rrëmbyshëm. Teksa e mbante në krahë, përkëdhelte kofshët e lëmyshkura të rrëshqitshme harroi gjithçka. Pa u menduar gjatë, si një shtysë e brendshme shumë e fortë, i kërkoi të martoheshin. Reta ngurroi, u përgjigj në mënyrë të papërcaktuar.

-Eshhtë herët, - i tha.

Më pas e shikoi gjatë, pak me dashuri, pak vrazhdë.

-E lëmë këtë bisedë për njëherë tjetër?

Më në fund heshti.

Ajo sikur tallej. Përse e shmangte? Mos kishte të tjerë në mes?

Neni iu duk vetja i përfshirë në një lojë djallëzore disi të dhunshme, nga e cila zor se do të dilte ndonjëherë. E pamundur ta kuptonte atë vajzë, njëlloj siç nuk mund të përndjesh fladit që përtërin një krah të plagosur future...

Mbasditeve Neni pinte kafe në bar "Topleci". I heshtur e i ftohtë me pak miq të vërtetë. Kur ra ora katër e pasadites, nga tavolina e cepit ku qe ulur, pa Retën të afro-

hej rrugës kryesore. Si të kishte shkrepur një rreze dielli shpirti iu ngroh, u ndje i gëzuar dhe buzëqeshi lehtë.

Klientët kthyen kokën njëherësh të gjithë, e ndoqën me sy derisa silueta e saj u fshih pas farmacisë. Në sytë prej të dehuri spikasnin hapur dëshira të errëta. Një femër e pashme si Fillareta qe balsam plagësh të harruara.

-Pelë hergeje, - tha Viktori.

-Ah, edhe ti xha Tori! - e ngacmoi kamerieri.

-Kalë, nuk i shkon, - vazhdoi Viktori, - pelë po dhe rënkoj mbytur.

-I fortë Belegu, - zëri i hollë hundor erdhi nga fundi i kafenesë.

-Eh, këto laviret, dreqi vetë janë. Dhe nuk të kthejnë, - tha një i dehur me tonin e atyre që i dinë mirë këto punë.

Neni i hipi gjaku në tru. Doli kokulur nga bar "Topleci". Shpirti i djalit u trazua, siç pështrijellohet pellgu me ujë të ndenjtur. Një ndjenjë e hidhur xhelozie e përcelloi. Mos ishte njëri prej atyre që shkonin me të?

"Bushtër" rënkoj dhe u ndje bosh, pa gravitet.

Kur e takoi nuk e mbajti dot veten, iu duk se po e shtypte qielli mbi kokë.

-Nga e dinë? - pyeti vrazhdë.

Një pikëpyetje habie u ndeh në gjithë shtatin e vajzës.

-Mendoj se e kupton, - vazhdoi ai.

Reta u mblodh e trandur.

-Kujtova se do të ma thojë ti, - i tha e bezdisur.

-I jep dot një shpjegim kësaj pune? - u vrejti Neni.

-Jo, nuk mund t'i jap, - ia ktheu prerë.

Me sytë e tejdukshëm, të kristaltë, e soditi gjatë. Zuri të qajë heshturazi, ftohtë pa emocion. Ai s'e kishte parë asnjëherë të lotuar.

"Kërkon të shfajësohet", mendoi tërë mllëf dhe i ktheu shpinën i zemëruar.

Reta as mori mundimin të vazhonte një bisedë të kotë pa pikë kuptimi. Nuk ishte e aftë të hynte në të tilla hulli, skenat e neverisnin. Ç'të vërtetë kërkonte prej saj? U largua qetësisht, e heshtur.

Ai mendoi se do të kthehej. E kërkoi të nesërmen, të pasnesërmen. Nuk e gjeti as atë ditë, as më vonë, derisa e pa veten për herë të parë siç qe në të vërtetë pa dashuri, të mjerë e të braktisur. Ëndrrat, thurur me aq përkushtim, u zhbënë në një çast të vetëm barbar dhe absurd. Tre vjet të hatashëm u vendosën në horizontin e turbullt të kohës së shkuar, ngarkuar me copëza të zbehta takimesh.

Reta u zhduk si një psherëtimë.

Për një farë kohe njerëzve nuk u ra në sy, pastaj zunë të shqetësohen. Burrat e kërkonin nëpër vendet ku e shihnin më parë, nuk e pikasinin dhe largoheshin të mërziutur, pa kuptuar tamam përse. Gratë e ndjenë edhe më shumë. Si të mbushnin kohën? Zgjasnin kokën prapa perdeve, vështronin rrugën mëngjesëve, mbasditeve, nuk e shihnin dhe ndiheshin keq.

Lagja e vjetër vazhdonte luftën e pashpallur, po tani jeta pati bërë kapërcime të mëdha. Kishte më shumë vajza të hijshme me funde të shkurtëra, se gra të ligështuara nëpër minimarkete.

\* Tregimi fitoi çmim në konkursin e Shen Valentinit për kete vit nga shoqata e shkrimterev "Bota e re"